



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**K R Y E T A R I**

Nr.734/8 Prot.

Tiranë, më 26/12/2016

**V E N D I M**

**Nr. 165, Datë 26/12/2016**

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË KËLCYRË, "MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË, LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE".**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10,15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e përputhshmërisë, ligjshmërisë, rregullshmërisë, vlerësimit financiar dhe menaxhimin e administrimit e asetëve të qëndrueshme", të ushtruar në Bashkinë Këlcyrë, për periudhën nga data 01.01.2013 deri 30.06.2016.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Këlcyrë nuk ka implementuar si duhet kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", duke mos ngritur një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm. Nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik dhe si rrjedhim nuk janë marrë në analizë nga asnjë sektor risqet që rrezikojnë realizimin objektivave. Institucioni nuk ka krijuar gjurmën e auditimit për proceset kryesore të punës. Në hartimin e raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk janë vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi me qëllim marrjen e masave për përmirësim. Nuk ka

rregulla të shkruara për raportimin e menaxherve të titullari, llojin e raporteve, frekuencën e tyre. Nuk është hartuar rregullore për zbatimin e ligjit për arkivat dhe as rregullore të kodit të etikës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, 16, 20, 22, 23, 24 të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**1.1.Rekomandim** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Të ngrihet GMS, të hartohet regjistri i riskut dhe në mënyrë periodike të analizohen dhe merren masa për risqet që rrezikojnë realizimin objektivave. Të hartohet rregullore për kodin e etikës dhe zbatimin e ligjit për arkivat. Për proceset kryesore të punës të hartohet gjurma e auditimit.

**Brenda muajit janar 2017**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Nëpunësi Autorizues nuk ka caktuar Nëpunësin Zbatues, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të aktiveve në administrim, si dhe nuk është mbajtur regjistër i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira, duke përcaktuar të dhëna si: sipërfaqja e objektit, numri dhe data e kontratës, afati i vlefshmërisë, objekti dhe qëllimi, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet për çdo muaj, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për krijimin e regjistrit kontabël të aktiveve në administrim si dhe të krijojë regjistër të veçantë për pasuritë e dhëna me qira ku të evidentohen të gjitha të dhënat e nevojshme sipas përcaktimeve ligjore.

**Brenda muajit janar 2017**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2013-2016 është dhënë ndihmë ekonomike padrejtësisht nga fondi rezervë, në vlerën 160,000 lekë, për personat të cilët nuk janë pjesë e skemës të ndihmës ekonomike, në kundërshtim me nenin 5 dhe 10 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të ndërpresë praktikën e dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi rezervë për persona të cilët nuk janë pjesë e skemës të ndihmës ekonomike.

**Brenda muajit dhjetor 2016**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se janë emëruar në detyrë 20 punonjës në pozicione pune që mbulohen nga statusi për nëpunësin civil, pa u zbatuar procedurat ligjore të rekrutimit, por me urdhër të brendshëm të Titullarit të institucionit, duke shkelur parimet e shanseve të barabarta, meritës dhe aftësive profesionale. Në një rast, është marrë në punë një punonjës i policisë bashkiake pa ju nënshtruar procedurës së përzgjedhjes dhe pa kaluar në formim në Akademinë e Rendit Publik.

Këto veprime janë shkak për tu bërë pjesë e administratës persona jo me kompetencën e duhur profesionale, me pasojë moskryerjen e detyrave si duhet, humbje të besimit të komunitetit të institucionit, si dhe janë në kundërshtim me nenin 20, 22 dhe 23 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me nenin 11 të urdhrin të përbashkët të ish-Ministrit të Pushtetit Vendor, datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores së brendshme Tip të Policisë Bashkiake dhe të Komunës”.

**4.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, nëpërmjet Njësisë të Burimeve Njerëzore të marrë masat dhe të zbatojë procedurat e rekrutimit në punë të punonjësve, sipas kërkesave të legjislacionit. Në rastet e marrjes në punë të punonjësve për plotësimin e vendeve vakant, pozicioni i të cilëve mbulohen nga statusi për nëpunësin civil, njësia e burimeve njerëzore dhe

Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të zbatojnë të gjitha procedurat e rekrutimit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi

**Në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 26 punonjës të cilët kanë pasur në dorëzim aktive (autovetura etj), dokumentacion shkresor, elektronik (dosje të taksapaguesve, lista të debitorëve, libra të kontabilitetit etj) dhe përpara largimit nga puna nuk është bërë dorëzimi i detyrës me procesverbal. Urdhrat respektive të largimit nuk kanë përcaktuar detyrimin për dorëzimin e detyrës dhe afatin përkatës, veprime në kundërshtim me pikën 13 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe pikën 50 të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 ”Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”.

**5.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa që në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës apo transferimit të punonjësit, më parë të bëhet prej tij dorëzimi i detyrës me procesverbal. Titullari të përcaktojë në urdhër afate dhe detyrimin e punonjësit për këtë qëllim, zyra e burimeve njerëzore dhe financës të mos bëjnë likuidimin përfundimtar (dhënien e pagës së fundit, librezës etj, pa u dorëzuar detyra me procesverbal (dokumentacioni shkresor, elektronik, inventarët etj.).

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative ish-Komuna Dëshnicë, nuk ka inventarizuar dhe arkivuar 4 dosjet të prokurimeve publike, për: “Blerje naftë”, “Mirëmbajtje objekte”, “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” dhe “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundisht”, veprime në pajtueshmëri me ligjin nr. 9154, datë 06.11.03 “Për arkivat”, si dhe dosjet teknike të investimeve kanë mangësi në dokumentacion, veprime në kundërshtim me UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

**6.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë (Njësia Administrative Dëshnicë), të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e 4 dosjeve të procedurave të prokurimit publik, si dhe Zyra e Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

**Në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit familjar, edhe pse si aksionare e vetme e shoqërisë “Ujësjellësi Këlcyrë” sh.a. pika (ii) e nenit 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, i jep të drejtën e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal. Nuk është realizuar përfshirja e vlerës së taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit.

**7.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, me qëllim arkëtimin e taksave vendore, të përgatisë dhe paraqesë për miratimin në Këshillin Bashkiak aktmarrëveshjen me shoqërinë “Ujësjellësi Këlcyrë” sh.a, duke i dhënë të drejtë shoqërisë të kryejë rolin e agjentit tatimor, duke arkëtuar bashku me faturën e ujit të pijshëm edhe taksat dhe tarifave vendore.

**Brenda muajit janar 2017**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve të Bashkisë Këlcyrë, ish-Komunës Sukë, Ballaban dhe Dishnicë, duke sjellë për pasojë krijimin e debitorëve, ku për

periudhën 2013-2016, të ardhurat e munguara në buxhetin e njësisë janë **42,297 mijë lekë**. Kjo vlerë përbëhet nga 14 debitor të biznesit të madh në vlerën 5,241 mijë lekë, 256 debitor të biznesit të vogël në vlerën 13,489 lekë, 3,422 debitor familjar për taksën mbi tokën bujqësore në vlerën 20,752 lekë, 2,174 debitor familjarë për taksën e pastrimit, gjelbërimit etj., në vlerën 2,815 lekë.

Nga detyrimi prej 42,297 mijë lekë, konstatohet mos evidentim në kontabilitet i vlerës 38,373 mijë lekë, duke sjell risk për humbje të gjurmës së debitorëve, veprime në kundërshtim me kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor” të ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 pika 1 dhe 2, neni 7 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe neni 12 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

**8.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, për arkëtimin e detyrimeve tatimore prej **42,297 mijë lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

**a-**Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

**b-**Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

**c-** Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në RSH “ të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten në vazhdimësi kamat vonesa.

**d-**Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

**e-** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të evidentojë dhe njoftojë familjarët për të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 71, të UMF nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

**f-** Zyra e Financës të kontabilizoj detyrimin për taksë dhe tarifa vendore në vlerën 38,373 mijë lekë dhe në bashkëpunim dhe me zyrën e taksave të administrojë edhe listat e debitorëve.

**Brenda muajit janar 2017**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga Bashkia Këlcyrë nuk është vepruar për të filluar nismën për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, duke mos përmbushur detyrimin ligjor për zhvillimin e territorit, detyrime të përcaktuar në nenin 20, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar dhe nenin 3, të VKM nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”.

**9.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të filloj procesin për studimin, hartimin dhe miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

**Brenda muajit janar 2017**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar listën përfundimtare të aseteve të Bashkisë Këlcyrë dhe 3 Njësite Administrative ish-Komunat, Dishnicë, Suk, Ballaban, duke mos pasur një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme në administrim, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Bashkia Këlcyrë nuk arrin të menaxhojë plotësisht asetet e paluajtshme në pronësi dhe përdorim, si rezultat i mos regjistrimit të drejtave të pronësisë apo përdorimit, mos ushtrimit të kontrolleve dhe saktësisht të kufijve të pronave, numrave pasurorë, sipas zonave kadastrale, mos shfrytëzimit të tyre në formën e qiradhënies, përfshi dhe tokat bujqësore të pandara në dispozicion, në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë vendore”.

**10.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për evidentimin e pronave të ish-Bashkisë Këlcyrë dhe 3 Njësive Administrative, ish-Komunat, Dishnicë, Suk, Ballaban, të kryej inventarizimin, vlerësimin, kontabilizimin, pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme të pasqyrave financiare dhe të marrë masa për regjistrimin e të gjitha aseteve në ZVRPP Përmet.

**Brenda muajit janar 2017**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë administron pasuri të llojit tokë truall dhe ndërtesë, me sipërfaqe totale prej **5,188 m<sup>2</sup>** të cilat nuk shfrytëzohen dhe janë jashtë kontrollit dhe administrimit të së drejtës së përdorimit, pasuri të cilat në rast të vënies në përdorim nëpërmjet dhënies me qira sipas VKM nr. 54, datë 05.2.2014, mund të gjeneronin të ardhura për bashkinë. Vetëm për periudhën e audituar (42 muaj), referuar çmimit minimal të dhënies me qira, efekt financiar i të ardhura do të ishte në vlerën prej 10,894,800 lekë.

**11.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për vënien në efikasitet të objekteve dhe sipërfaqeve të truallit të pa shfrytëzuar duke rritur përpjekjet menaxheriale për dhënien e tyre me qera.

**Brenda muajit janar 2017**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative, ish-Komunat, Dishnicë, Suk, Ballaban nuk kanë marrë në dorëzim me procesverbal nga institucionet qendrore asetet e qëndrueshme, në pronësi, nuk kanë kryer kolaudimin dhe vlerësimin, inventarizimin kontabël dhe fizik, nuk kanë aplikuar në ZVRPP Përmet për regjistrim, sipas fushave përkatëse të përdorimit të secilës pronë, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**12.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe krijojë komisionin për marrjen në dorëzim të aseteve nën administrim, duke hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim të pronave, akt i cili duhet të nënshkruhet nga dorëzuesi i pronës dhe përfituesi (Bashkia Këlcyrë), si dhe duhet të shoqërohet me tregues dhe element teknikë si harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre etj.

**Brenda muajit janar 2017**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka derdhur për llogari të buxhetit të shtetit **tatimin në burim** për të ardhurat nga qiratë e objekteve, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 33 germa “ë”, “pagesat për qiratë”, detyrim i cili për periudhën 2013-6/mujori 2016 shkon në vlerën **419,500 lekë**.

**13.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të derdhë për llogari të buxhetit të shtetit detyrimin prej **419,500 lekë**, si tatim në burim, realizuar nga arkëtimi i të ardhurave nga qiratë e objekteve.

**Brenda muajit janar 2017**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, në 23 raste, për shkelje të konstatuara në fushën e ndërtimit, nuk ka aplikuar dënime me gjobë, në vlerën prej **11,500,000 lekë**, veprime në kundërshtim me pikën 8/a të nenit 82, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 52, pika 1, germa “e”, ligjit 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5 germa “b”, sipas pasqyrës bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

**14.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për vendosjen e gjobave dhe arkëtimin e tyre në vlerën **11,500,000 lekë**, për rastet e shkeljeve në ndërtimet pa leje dhe të dokumentuara nëpërmjet procesverbaleve dhe vendimet të marra nga IMT Bashkia Këlcyrë.

**Brenda muajit mars 2017**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Policia Bashkiake nuk ka dokumentuar ushtrimin e funksioneve pasi: nuk janë hartuar planet e vendosjes në shërbim; nuk është përgatitur dhe mbajtur libri i shërbimit 24 orësh; nuk është hartuar plani ditor i veprimit; planet mujore janë formal; nuk ka ushtruar kontrole për mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e pronës, për respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes, të parkimit etj, nuk ka vendosur asnjë gjobë për personat që kryejnë kundravajtje administrative; si dhe nuk ka bashkëpunuar me Zyrën e taksave për administrimin e të ardhurave vendore, veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 13 dhe 14, pika 8 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës” dhe lidhjen nr. 1-3 të urdhrat të përbashkët të Ministrisë të Rendit dhe Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores së brendshme Tip të policisë bashkiake e të komunës”.

**15.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të vërë në efikasitet strukturën e policisë bashkiake. Të kërkoj nga Këshilli Bashkiak miratimin e nivelit të gjobave sipas llojit të shkeljeve administrative.

**15.2. Rekomandim:** Policia Bashkiake, të përgatisë dhe plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për pasqyrimin e veprimtarisë së përditshme. Struktura e policisë bashkiake nëpërmjet urdhrave të titullarit dhe kërkesave të sektorëve përkatës të vihet në mbështetje të strukturave të tjera të bashkisë për kontrollin e territorit, vjeljen e taksave vendore, administrimin e aseteve etj.

**Në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për vlerën debitore **326,252 lekë me mundësi arkëtimi**, të pasqyruar në bilancin e vitit 2015 për 38 punonjës të ish-komunës Ballaban, nga titullari, zyra e burimeve njerëzore dhe financës nuk është marrë asnjë mas, si mosdhënia e librezës së punës, mos mbajtja e pagës së fundit.

**16.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të ndjekë të gjitha hapat ligjore për vjeljen e vlerës 326,252 lekë nga 38 ish-punonjës të ish-komunës Ballaban, sipas listave analitike që disponohen në arkivin e bashkisë.

**Brenda muajit janar 2017**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se makineritë, automjetet dhe pajisjet në pronësi të Bashkisë Këlcyrë, janë të shpërndara dhe nuk janë nën ruajtjen nga institucioni, si dhe nga Njësia Administrative ish-Komuna Sukë dy autovetura nuk ruhen në ambientet e bashkisë, por pranë banesave private, jashtë vëmendjes, kujdesit, mbikëqyrjes së përgjegjësit material, duke shkaktuar premisa për dëmtime apo humbje të tyre, veprime në kundërshtim me paragrafin 5, 10, 19, 23, 26, 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”.

**17.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për kthimin dhe ruajtjen e makinerive, autoveturave apo dhe pajisjeve në ambientet nën administrim të institucionit apo pikë

magazinimi e ruajtje në mbikëqyrje dhe kontrollin e tij; të bëj inventarizim të hollësishëm të mjeteve duke përcaktuar gjendjen fizike, mekanike, motorike, etj dhe në rast konstatimi të mungësive apo dëmtimeve fizike apo mekanike, të ngarkohet/en me përgjegjësi materiale personi/at përgjegjës sipas rregullave në fuqi.

**Brenda muajit janar 2017**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se automjeti në pronësi të Njësisë Administrative ish-Komuna Ballaban, është dorëzuar në njësinë administrative pa procesverbal për gjendjen teknike të tij dhe ka shpenzime të larta për mbajtjen në gjendje pune, pasi vetëm për 6-mujorin e parë të vitit 2016 është shpenzuar 412,420 lekë.

**18. 1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të ngrëjë komision me specialistë të fushës, për vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të mjetit të ish-Komunës Ballaban, dhe pas raport vlerësimit të gjykojë dhe vlerësoj mbi gjendjen e mjetit, nevojën për mbajtjen e tij në punë, për vijimin e procedurave ligjore për nxjerrjen e tij në ankand.

**Brenda muajit janar 2017**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka bërë hyrje një pompë uji blerë sipas urdhër shpenzimit nr. 264, datë 29.10.2015 dhe faturës subjektit nr. 32, datë 16.10.2015, për vlerën **300,000 lekë**, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**19. 1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të bëjë hyrje pompën e ujit me vlerë 300,000 lekë, pasi nuk është administruar nëpërmjet magazinës, sipas urdhër shpenzimit nr. 264, datë 29.10.2015

**Brenda muajit janar 2017**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna më parë, u konstatua se: Bashkia Këlcyrë nuk ka kontabilizuar dhe arkëtuar masat e zhdëmtimit për vlerën **4,096,510 lekë** dëm ekonomik, sipas shkresave nr. 434/53, datë 01.07.2013 dhe nr. 351/68, datë 02.2.2011 të KLSH.

**20.1. Rekomandimi:** Bashkinë Këlcyrë, të zbatojë rekomandimet e mëparshme të KLSH, sipas shkresave nr. 434/53, datë 01.07.2013 dhe nr. 351/68, datë 2.2.2011, duke kontabilizuar dhe ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **4,096,510 lekë**, përkatësisht: B.A. 218,751 lekë, V.C. 23,065 lekë, H.Sh. 23,065 lekë, “██████████” 500,000 lekë, “██████████” shpk 574,360 lekë, “██████████” shpk 838,172 lekë, “██████████” shpk 165,800 lekë, “██████████” shpk, 753,271 lekë dhe 1,000,026 lekë nga 26 persona sipas listës të administruar në Bashkinë Këlcyrë.

**Brenda muajit shkurt 2017**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.**

Mbështetur në nenin 15 shkronja (b) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi procedurave administrative”, pjesa V, kreu I “Akti administrativ”, nenet 98-102, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 21-33 “Funksionimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil”, nenet 608-628 në vijim dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të nxirren aktet administrative përkatëse (Vendimet ekzekutive) dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha

shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile, me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 21,744,494 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Firma e pastrimit të qytetit Këlcyrë “██████████” ka përfituar tepër vlerën **220,218 lekë dëm ekonomik**, për volume **punimesh të pakryera**, pasi nuk janë zbritur nga situacionet e punimeve zërat e punës “Pastrim i parë i unazës Këlcyrë” dhe “Mirëmbajtje rrugë e sheshe” për sipërfaqen 36,000 m<sup>2</sup>/ditë, për periudhën nga data 25.8.2014 deri 28.2.2015, periudhë në të cilën unaza e qytetit i është nënshtruar rikonstruksionit dhe asfaltimit sipas kontratës nr. 4985, datë 30.7.2014. Veprime në kundërshtim me kërkesat e pikës 36, 54 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me nenin 13 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **220,218 lekë**, për punë të pakryer nga **firma e pastrimit “██████████”**, pasi ka përfituar padrejtësisht zërat e punës “Pastrim i Parë i Unazës Këlcyrë Qendër të Qytetit” dhe “Mirëmbajtje Rrugë e Sheshe”, për periudhën nga data 25.8.2014 deri më 28.2.2015, për arsye se unaza e qytetit i ishte nënshtruar rikonstruksionit dhe asfaltimit, sipas kontratës nr. 4985, datë 30.7.2014.

**Brenda muajit shkurt 2017**

**2. Gjetje nga auditimi:** U konstatua se subjekti “██████████” ka përfituar 2 herë tvsh për zërin “makineri e pajisje”, pasi subjekti në preventivin dhe situacionin përfundimtar i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veçmas vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veçmas vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjekti **514,068 lekë dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit, përkatësisht për “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Kamber Benja Këlcyrë” vlera 283,220 lekë dhe “Sistemim lulishte Këlcyrë” vlera 230,848 lekë.

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **514,068 lekë**, nga subjekti “██████████”, përfituar 2 herë tvsh në zërin “makineri e pajisje”, në objektet “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Kamber Benja Këlcyrë” dhe “Sistemim lulishte Këlcyrë”.

**Brenda muajit mars 2017**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i objektit “Skema ujitëse dhe ujitja e fushës Ballaban” Këlcyrë, rezultoi se fondit limit është llogaritur më tepër për vlerën **128,412 lekë dëm ekonomik**, për arsye se llogaritja e fondit limit sipas çmimeve të manualit të vitit 2015 e krahasuar me çmimet të analizës sipas preventivit konstatohet se janë me të larta se ato të manualit teknik të punime të ndërtimit, konkretisht: sipas artikullit nr. 4.60 analizës, çmimi i 1/ton FV tuba çeliku Φ 600/6.3 mm L=20m, çmimi është sipas manualit të vitit 2015 është 153,368 lek/ ndërsa sipas preventivit të hartuar nga preventivuesi “██████████” shpk çmimi është 170.669 lekë 1 ton tuba, për sasinë prej 7.48 ton, sipas vlerave të manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015.

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **128,412 lekë**, nga preventivuesi “██████████” shpk me përfaqësues ing. **G.P.** për arsye se ka rritur vlerën e preventivit për zërin nr. 4.60 analizës, çmimi i F.V.tuba çeliku Φ 600/6.3 mm L=20m, për sasinë prej 7.48 ton, në objektin “Skema ujitëse dhe ujitja e fushës Ballaban” Këlcyrë, për vitin 2015.

**Brenda muajit janar 2017**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Këlcyrë për periudhën janar 2013-6/mujori 2016 janë bërë pagesa për **shpërblimin e 21 këshilltarëve** të bashkisë, të cilët janë shpërblyer për punë të pakryer , pasi nuk kanë marrë pjesë në asnjë mbledhje të këshillit, veprime jo në përputhje me pikën 2 të nenit 29, pikën 2 dhe 9 të nenit 31 të ligjit 8652 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, duke sjellë përfitim të padrejtë të vlerës totale **634,234 lekë dëm ekonomik**.

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e detyrimit **634,234 lekë**, nga 21 ish-këshilltarët dhe këshilltarët aktual të këshillit bashkiak, sipas listës trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Brenda muajit mars 2017**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Këlcyrë rezultoi se për vitin 2015-2016 është krijuar **dëm ekonomik në vlerën prej 63,500 lekë**, për G.H. si pagesë e paligjshme për persona me aftësi të kufizuar, në kundërshtim me VKM nr. 618, datë 7.09.2006 “Përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi kufizuar”.

**5.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **63,500 lekë** për G.H. si pagesë e përfituar tepër.

**Brenda muajit mars 2017**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Këlcyrë nuk është aplikuar saktë **tarifa e vlerës së qirasë** lek/ha/vit, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratës së qirasë, për kontratën e lidhur midis bashkisë Këlcyrë dhe kompanisë [REDAKTUAR] sh.a, në kundërshtim me VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja 2, pika 7, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me efekt financiar **2,150,400 lekë dëm ekonomik** për buxhetin e bashkisë.

**6.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **2,150,400 lekë** nga [REDAKTUAR] sh.a, si rezultat i mos aplikimit të drejtë të tarifës së qirasë për vendosje antene të telefonisë të lëvizshme.

**Brenda muajit mars 2017**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në ish-Komunën Dëshnice, në prokurimin “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundishte” viti 2013, me fond limit 44,449,531 lekë, rezultoi se është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE [REDAKTUAR], me vlerën më të lartë të ofertës ekonomike dhe është s’kualifikuar oferta e OE “[REDAKTUAR]” me vlerë më të vogël sesa oferta fituese me pretendimin se mungon “*vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve vendore në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit*” edhe pse operatori i shpallur fitues nuk ka paraqitur vërtetim për taksat vendore nga të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit të tij. Nga s’kualifikimi i padrejtë i OE me vlerë më të ulët KVO i ka shkaktuar buxhetit të shtetit **574,700 lekë dëm ekonomik**, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa *d* dhe *dh*, neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, dhe nenin 20, “Mosdiskriminimi”.

**7.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **574,700 lekë**, nga anëtarët e KVO përkatësisht: E.Z. A.M. R.S. dhe ish Titullari i AK B.F. nga 143,675 lekë secili, për diferencë të krijuar nga skualifikimi i ofertës më të ulët dhe asaj të shpallur fituese në tenderin “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundishte”.

**Brenda muajit mars 2017**

**8. Gjetje nga auditimi:** Në ish-komunën Dëshnice, është kryer shpenzim i pajustificuar për vlerën **40,000 lekë dëm ekonomik** për blerjen e “2 fenerë të përparmë” për automjetin me targë PR 1990 B, pasi mungon procesverbali i konstatimit të arsyes së ndërrimit të fenerëve

apo procesverbali i policisë për të konfirmuar nëse mjeti ka qenë i përfshirë në aksident, veprime në kundërshtim me UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” dhe UMF nr. 30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**8.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **40,000 lekë** nga D.V. si shpenzim i pajustificuar për blerjen e 2 fenerëve.

**Brenda muajit janar 2017**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në ish-komunën Dëshnice, u konstatua vlera **141,000 lekë dëm ekonomik**, për **pritje përcjellje** me rastin e festës së Çlirimit të Atdheut me pjesëmarrjen e 300 personave nga 15 fshatrat e komunës, pasi shpenzimi nuk ka mbështetje ligjore dhe as vendim të Këshillit Bashkiak, si nuk ka listë të miratuar të pjesëmarrësve, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar.

**9.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **141,000 lekë** nga B.F. ish-Kryetar i Komunës Dëshnice dhe R.S. ish-përgjegjëse financës nga 70,500 lekë secili, për shpenzim të paligjshëm për pritje përcjellje me rastin e festës së Çlirimit të Atdheut.

**Brenda muajit mars 2017**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimeve me bankën të ish-Komuna Dëshnice për periudhën janar 2013-2015 u konstatua se për 7 punonjës janë kryer shpenzime **për dieta** në vlerën **808,000 lekë dëm ekonomik**, përfituar padrejtësisht, pasi dokumentacioni i tyre nuk është i argumentuar, urdhërsërbimeve u mungon qëllimi i shërbimit, mungojnë ftesat ose dokumente të tjera të kësaj natyre për të argumentuar qëllimin e shërbimit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” pika III/3 nënpika 3.2, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**10.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **808,000 lekë** përfitim të pa drejtë **dieta** për vitet 2013-2015 sipas urdhër shpenzimeve përkatëse, konkretisht: B.F. 323,500 lekë, R.S. 99,000 lekë, E.I. 155,500 lekë, A.L. 50,000 lekë, P.J. 107,000 lekë, A.M. 33,000 lekë dhe D.V. 40,000 lekë.

**Brenda muajit mars 2017**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në ish-Komunën Dëshnice për periudhën 2013-2015, u konstatuan shpenzime të paligjshme për përdorimin e telefonisë **celulare** për vlerën **172,619 lekë dëm ekonomik**, në kundërshtim me pikën 9 dhe 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publikë” dhe VKM nr. 545, datë 11.08.2011. Nga telefoni fiks i zyrës të ish-kryetarit të Komunës Dëshnice B.F. sipas faturave të kompanisë “██████████” konstatohet se përveç paketës “pajtim familjar” ka pasur telefonata ndërkombëtare të pa ligjshme në vlerën **30,619 lekë dëm ekonomik**.

**11.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **172,619 lekë** për shpenzime celulare të përfituara padrejtësisht për periudhën 2013-2015, nga B.F. 145,619 lekë, E.I. 6,000 lekë, D.V. 6,000 lekë, A.M. 5,000 lekë, N.Sh. 4,000 lekë, H.H. 2,000 lekë, S.B. 3,000 lekë dhe A.R. 1,000 lekë.

**Brenda muajit mars 2017**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në ish-komunën Dëshnicë rezultoi vlera **135,000 lekë dëm ekonomik**, për **mungesë inventari**, përkatësisht B.F. 1 kompjuter laptop hp550 në vlerën 105,000 lekë dhe R.S. 1 Printer Samsung 4300 në vlerën 30,000 lekë.

**12.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **135,000 lekë**, për mungesë inventari të 2 pajisjeve kompjuterike, nga B.F. 105,000 lekë dhe R.S. 30,000 lekë.

**Brenda muajit janarit 2017**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimeve me bankës të ish-komunës Ballaban u konstatua se nga 2 punonjës janë përfituar **dieta** në vlerën **130,000 lekë dëm ekonomik**, kur dokumentacioni shoqërues është i parregullt dhe i pa justifikuar, veprime në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, përkatësisht: vlera 75,000 lekë, për 30 ditë dieta në Tiranë, përfituar nga A.D. sipas urdhër shpenzimeve nr. 45, datë 03.4.2013, nr. 127, datë 03.7.2013, nr. 226, datë 06.11.2014 dhe nr. 126, datë 04.07.2015, dhe vlera 55,000 lekë, për 22 ditë dieta në Tiranë, përfituar nga Dh.A. të komunës, sipas urdhër shpenzimeve nr. 111, datë 19.06.2015, nr. 226, datë 06.11.2014, nr. 45, datë 03.4.2013, nr. 127, datë 03.7.2013.

**13.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **130,000 lekë**, përkatësisht: A.D. ish-Kryetar i Komunës për 75,000 lekë dhe Dh.A. Ish-Përgjegjëse e Financës për 55,000 lekë, për dieta të përfituara në kushtet e një dokumentacioni të parregullt dhe të pajustificuar.

**Brenda muajit mars 2017**

**14. Gjetje nga auditimi:** Komuna Ballaban me rastin e festave të fund vitit ka kryer **shpenzim të paligjshëm**, për vlerën **33,330 lekë dëm ekonomik**, për një koktej me pjesëmarrjen e 65 punonjësve të administratës dhe tjerë, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

**14.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **33,330 lekë**, shpenzim i paligjshëm, për koktej me rastin e festave të fund vitit, përkatësisht nga A.D. dhe Dh.A. në vlerën 16,665 lekë secili.

**Brenda muajit janar 2017**

**15. Gjetje nga auditimi:** U konstatua se në ish-Komunën Ballaban është kryer shpenzim për “Riparime rrugësh të brendshme Ballaban”, për vlerën **320,700 lekë dëm ekonomik**, pa miratim në Këshillin e Komunës, në mungesë të dokumenteve vërtetuese dhe fotografimeve para dhe pas punimeve objektit, si dhe me situacion të nënshkruar jo nga specialistë të fushës por nga ish-kryetari komunës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar dhe kreun IV shkronja C me UAPP nr. 02, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 1 dhe 4, ndryshuar me UAPP nr. 5, datë 16.7.2013 dhe nr. 01, datë 28.02.2014.

**15.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **320,700 lekë** nga A.D. dhe Dh.A. për shpenzim të argumentuara dhe justifikuara me dokumentacion ligjor, si dhe të pa miratuar në Këshillin e Komunës.

**Brenda muajit mars 2017**

**16. Gjetje nga auditimi:** U konstatua vlera **121,320 lekë dëm ekonomik**, për **tejkalim normative të karburantit**, për 674 litra naftë, pasi nga rakordimi i fletudhëtimeve me furnizimet dhe normativat e karburantit për automjetin e ish-komunës Ballaban, janë bërë dalje 1,124 litra karburant, në vend të 450 litra sipas normativës, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**16.1. Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **121,320 lekë**, tejkalim normative të karburantit, përkatësisht nga drejtuesi i mjetit

A.M. magazinieri E.B. përgjegjësia e financës Dh.A. si dhe ish-kryetari i komunës A.D. nga 30,330 lekë secili.

#### **Brenda muajit shkurt 2017**

**17. Gjetje nga auditimi:** Në ish Komunën Sukë për periudhën janar 2013-2015, nëpërmjet procedurës së prokurimit me vlera të vogla janë blerë karta rimbushëse celulari në vlerën totale 150,000 lekë të cilat janë përfituar nga z. G.M. me detyrë ish kryetar komune, veprime në kundërshtim me pikën 9 dhe 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publikë”. Vlera **150,000 lekë** përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e ish Komunës Sukë.

**17.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **150,000 lekë** nga ish kryetari i Komunës Sukë G.M.

#### **Brenda muajit mars 2017**

**18. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën janar 2013-2015 në ish-komunën Sukë janë kryer shpenzime për dieta për 3 punonjës në vlerën **367,500 lekë dëm ekonomik**, në mungesë të faturës tatimore me TVSH dhe të argumentimit të qëllimit të shërbimit, pasi në asnjë rast nuk ka program pune, ftesë apo çdo dokument tjetër, për të justifikuar qëllimin e shërbimit, në kundërshtim me pikën (b), paragrafi III dhe pikën 2 paragrafi V të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, me VKM nr. 1058, datë 21.10.2009 “Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për TVSH” të ndryshuar.

**18.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **367,500 lekë**, dieta të pajustificuara dhe përfituara nga G.M. 302,500 lekë, H.Sh. 32,000 lekë, E.H. 33,000 lekë.

#### **Brenda muajit mars 2017**

**19. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër të ish Kryetarit të Komunës Sukë në fund të muajit maj 2015, është bërë dalje nga magazina 2,000 litër karburant në vlerën **346,000 lekë** për furnizimin e autoveiturës së komunës për periudhën janar-maj 2015 (periudhë përpara datës së urdhrorit dhe fletëdaljes), pasi për të gjithë këtë periudhë mungojnë fletët e udhëtimit për lëvizjen e mjetit dhe konsumin e karburantit. Për arsye të mungesës së dokumenteve autorizues dhe vërtetues (urdhri dhe fletëdalja) me kohën e përshkrimit që bëhet në këto dokumente, si dhe për arsye të mos vërtetimit me dokumente të sasisë së karburantit të shpenzuar, vlera prej 346,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e ish Komunës Sukë.

**19.1.Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **346,000 lekë** si shpenzime karburanti të pa argumentuara dhe justifikuara nga G.M. dhe drejtuesi i mjetit S.K.

#### **Brenda muajit mars 2017**

### **B/1. SHPENZIME NË KUNDËRSHTIM ME PRINCIPET E EFEKTIVITETIT, EFIÇENCËS DHE EKONOMICITETIT TË FONDEVE PUBLIKE (3-E).**

**20. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Skema ujitëse dhe ujitja e fushës Ballaban” Këlcyrë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume **punimesh të pakryera** në vlerën **6,392,567 lekë** pa t.v.sh, në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 31.05.2016 të lidhur mes titullarit të AK Bashkia Këlcyrë dhe BOE “██████████” sh.p.k dhe “██████████” sh.p.k, kontratën datë 31.05.2016 të

lidhur mes titullarit të AK Bashkia Këlcyrë dhe ing. S.Sh. për mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht pika 2, pika 3 si dhe me udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 3.

**20.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **6,392,567 lekë** pa t.v.sh nga BOE “██████” sh.p.k dhe “██████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën datë 31.05.2016 me objekt “Skema ujitëse dhe ujitja e fushës Ballaban”, Këlcyrë”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Brenda muajit mars 2017**

**21. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Katundisht (faza 2)”, Dëshnicë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume **punimesh të pakryera** në vlerën **4,857,219 lekë** pa t.v.sh, në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 05.06.2013 të lidhur mes ish-titullarit të AK dhe BOE “██████” sh.p.k dhe “██████” shpk, pika 1 dhe pika 5.2, kontratën datë 05.06.2013 të lidhur mes ish-titullarit të AK dhe ing. A.P. për mbikëqyrjen e punimeve e konkretisht pika 1, kontratën datë 29.04.2015 e lidhur mes ish-Titullarit të AK për kolaudimin e punimeve, konkretisht paragrafi I, si dhe me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9.

**21.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **4,857,219 lekë** pa t.v.sh nga BOE “██████” sh.p.k dhe “██████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën datë 05.06.2013 me objekt “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Katundisht (faza 2)”, Dëshnicë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Brenda muajit mars 2017**

**22. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Sistemim Asfaltim Unaza Këlcyrë Qendër - Faza e II-të” Këlcyrë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume **punimesh të pakryera** në vlerën **1,699,578 lekë** pa t.v.sh, në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 25.01.2016 të lidhur mes titullarit të AK dhe BOE “██████” sh.p.k dhe “██████” sh.p.k, kontratën datë 25.01.2016 të lidhur mes titullarit të AK dhe ing. K.I. për mbikëqyrjen e punimeve, kontratën datë 10.06.2016 të lidhur mes Titullarit të AK dhe ing. S.Sh. për kolaudimin e punimeve, me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, pika 9, paragrafi i dytë dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 3 dhe pikat 8.1 e 8.3.

**22.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,699,578 lekë** pa t.v.sh nga BOE “██████” sh.p.k dhe “██████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën datë 25.01.2016 me objekt “Sistemim Asfaltim Unaza Këlcyrë Qendër - faza e ii-të” Këlcyrë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Brenda muajit mars 2017**

**23. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Sistemim asfaltim unaza Këlcyrë qendër - faza e i - rë” Këlcyrë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të

punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume **punimesh të pakryera** në vlerën **625,944 lekë** pa tvsh, në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 30.07.2014 të lidhur mes titullarit të AK dhe OE “██████” sh.p.k, kontratën datë 15.07.2014 të lidhur mes titullarit të AK dhe subjektit “██████” me ing. R.T. për mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht pikat 2 dhe 3, me Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, pika 9, paragrafi i dytë dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3.

**23.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **625,944 lekë** nga OE “██████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 30.07.2014 me objekt “Sistemim Asfaltim Unaza Këlcyrë Qendër - faza e I Këlcyrë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Brenda muajit shkurt 2017**

**24. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” Këlcyrë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume **punimesh të pakryera** në vlerën **664,500 lekë** pa t.v.sh, në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 30.07.2014 të lidhur AK dhe OE “██████” sh.p.k, kontratën datë 30.07.2014 të lidhur mes AK dhe ing. A.P. për mbikëqyrjen e punimeve, pika 2, kontratën datë 29.04.2015 të lidhur mes ish-titullarit të AK dhe ing. L.Th. për kolaudimin e punimeve, pika 1.

**24.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **664,500 lekë** pa t.v.sh nga OE “██████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 30.07.2014 me objekt “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” Këlcyrë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Brenda muajit mars 2017**

**25. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Ndërtimi i urës në fshatin Vinokash” Këlcyrë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume **punimesh të pakryera** në vlerën **453,685 lekë** pa t.v.sh, në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 11.07.2014 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor dhe OE “██████” sh.p.k, kontratën datë 30.07.2014 të lidhur mes AK dhe ing. T.S. për mbikëqyrjen e punimeve, paragrafi i dytë, kontratën datë 25.08.2014 të lidhur mes AK dhe ing. D.P. për kolaudimin e punimeve, pika 1.

**25.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **453,685 lekë** pa t.v.sh nga OE “M” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 11.07.2014 me objekt “Ndërtimi i urës në fshatin Vinokash” Këlcyrë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Brenda muajit mars 2017**

## **C. MASA ADMINISTRATIVE**

### **C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 53, 56, 63, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet respektive, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), **29 punonjësve** si më poshtë:

### **Bashkia Këlcyrë.**

**1. K.N.** Kryetar i Bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e **titullarit të AK**, për shkeljet si më poshtë:

- nuk i ka ngarkuar detyrë njësisë së prokurimit dhe nuk ka ngritur as grup pune me specialist për llogaritjen e fondit limit në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim Unaza Këlcyrë Qendër, faza e parë për vitin 2014”, por llogaritja e fondit limit është kryer nga inxhinieri i jashtëm, i cili nuk ka marrëveshje ose kontratë me bashkinë, veprim në kundërshtim me nënpikën (a) të pikës 2, kreu V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar si dhe me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmën standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- për mos anulimin e procedurës së prokurimit në objektin “Sistemim asfaltim unaza Këlcyrë faza e II” Bashkia Këlcyrë, për vitin 2015, pasi ka patur shkelje në hartimin e disa kriterëve të vecanta të kualifikimit, të cilat kanë ndikuar në eliminimin e operatorëve ekonomik, si dhe për shpalljen padrejtësisht fitues të BOE “XXXXXXXXXX” shpk, pasi nuk plotëson 2 kriterë, sipas procesverbalit datë 30.12.2015 të KVO.

**2. J.N.** specialist i urbanistikës, në cilësinë e **anëtarit të njësisë së prokurimit,**

**3. A.P.** inspektorë ndërtimi, në cilësinë e **anëtarit të njësisë së prokurimit,**

**4. P.H.** ish- sekretare e Kryetarit të Bashkisë për periudhën 01.01.2013-28.02.2016 dhe në cilësinë e **anëtares së njësisë së prokurimit,** për shkeljet e përbashkëta, si më poshtë:

Në tenderin me objekt “**Sistemim asfaltim Unaza Këlcyrë Qendër, faza e parë**“ në hartimin e specifikimet teknike të DT të vendosura për përmbushjen e kapacitetit teknik, kanë vendosur kriterë diskriminuese dhe nuk kanë krijuar kushte për trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, duke penguar konkurrencën e hapur, veprime që janë në kundërshtim me nenin 20 dhe 23 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar konkretisht:

a. është vendosur kriteri se operatori për periudhën maj 2012-maj 2014 të ketë pasur të punësuar dhe paguar sigurimet për jo më pak se 20 punonjës për secilin muaj, në vend që të kërkohej numri mesatar i punonjësve për këtë periudhë.

b. është vendosur kriteri se operatori duhet të paraqesë dëshmi se zotëron linjë prodhimi inertesh në pronësi, me qira ose me kontratë furnizimi, kriter i cili ka qenë i panevojshëm, i paargumentuar, jo në përputhje me punët që prokurohen, shmang nga konkurrimi operatorë dhe krijon kushte favorizuese për disa të tjerë, duke u bërë pengesë për konkurrencën e hapur.

**5. Xh.D.** përgjegjës i ndihmës ekonomike, në cilësinë e **kryetarit të KVO,**

**6. E.L.** zëdhënës i Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e **anëtarit të KVO,**

**7. B.A.** me detyrë inspektor i taksave, në cilësinë e **anëtarit të KVO,**

për shkeljet e përbashkëta, si më poshtë:

Në tenderin me objekt “**Sistemim asfaltim Unaza Këlcyrë Qendër, faza e parë**“, kanë kualifikuar fitues operatorin ekonomik “██████████” me vlerën më të lartë të ofertës, i cili nuk plotëson të gjitha kërkesat e dokumenteve standarde të tenderit për arsye se: në dokumentet e paraqitura prej tij mungon pjesa e aktivitetit të bilancit në pasqyrat financiare të vitit 2013, nuk është plotësuar kriteri për përvoja të mëparshme në punë të ngjashme sepse nuk është paraqitur akti i marrjes në dorëzim si dhe faturat tatimore për çdo situacion për punimet e kryera në tenderin me objekt “Sistemim lulishte Këlcyrë”, tender i cili është përzgjedhur nga ofertuesi për të vërtetuar përvojën e mëparshme në punë të ngjashme, nuk është plotësuar kriteri i kapacitetit teknik, sepse për mjetet në pronësi që shënohen në regjistrat publik nga tre mjete të kërkuara operatori ka paraqitur me dokumentacion të saktë vetëm dy, ndërsa për makineritë që nuk shënohen në regjistrat publik faturat e blerjes dhe deklaratat doganore janë të hershme 2-6 vjet dhe kjo nuk garanton pronësinë aktuale të ofertuesit.

**8. A.L.** specialist i kadastrës të bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e kryetarit të KVO

**9. S.V.** inspektor i taksave vendore, në cilësinë e antarit të KVO

**10. A.Q.** inspektor i taksave vendore, në cilësinë e antarit të KVO, për shkeljet e përbashkëta, si më poshtë:

**a.** Në objektin “**Sistemim asfaltim unaza Këlcyrë faza e II**” Bashkia Këlcyrë, për vitin **2015**, me fond limit 7,859,020 lekë pa tvsh, procedura kërkesë me propozim, tender i zhvilluar në datë 28.12.2015, nga KVO e cila padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “██████████” shpk për vlerën 7,828,195 leke pa tvsh, pasi nuk plotëson 2 kriteret, sipas procesverbalit datë 30.12.2015, konkretisht:

-nuk ka pronësinë për makineritë betoniere, pasi mungon pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare të vitit 2014-2015 dhe mungon inventari fizik.

-nuk plotëson numrin e të punësuarve të kërkuar për 3-mujorin e parë 2014, ndërsa për të njëjtën shkelje është skualifikuar operatori “██████████” shpk, pra KVO ka vepruar me 2 standarte. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe me kërkesat e nenit 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Autoriteti kontraktor duhej të kishte anuluar këtë procedurë prokurimi, pasi gjithë operatorët ekonomik paraqesin mos plotësim të kriterëve. Në kushtet e mos plotësim të kriterëve nga 4 operatorët ekonomik pjesëmarrës, KVO mund ti jepte prioritet operatorit “██████████” shpk me ofertë me leverdi ekonomike për vlerën 6,404,540 leke pa tvsh, pasi mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta, mund të konsideroheshin devijime të vogla për arsye se nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës. Kështu është krijuar diferenca për vlerën 1,423,655 lekë pa tvsh mos efektivitet në fondet publike për buxhetin e bashkisë (██████████ 7,828,195-6,404,540 ██████████). Operatori ekonomik “██████████” shpk paraqet mangësi në 3 raste, të cilat nuk prishin realizimin e kontratës publike, konkretisht:

-pretendimi i KVO se drejtuesi teknik i punimeve duhet të qëndrojë gjithë kohën në objekt dhe që nuk është në listpagesa, qëndron pjesërisht, pasi e ka detyrë ligjore ndjekjen e punimeve dhe mungesa në listpagesa duhej vërtetuar nëse stafi ka patur ndryshime dhe nëse ka kontrata me emra të rinjë, duke sqaruar kështu dhe OE ankimes.

-pretendimi i KVO se nuk ka paraqitur kontratë furnizimi për prodhim inertesh, nuk qëndron, pasi OE ka paraqitur kontratën datë 5.5.2015 me subjektin ██████████ shpk me afat kohor 5 vjeçar.

-pretendimi i KVO se analizat e çmimeve nuk janë sipas manualit por janë më të vogla, nuk qëndron, pasi nuk ndikojnë në objektin, përkundrazi sjellin leverdishmëri ekonomike, ndërsa për BO fitues “██████████” shpk i cili ka paraqitur çmime të larta nuk është trajtuar si shkelje, pra KVO ka vepruar me 2 standarte.

-pretendimi i KVO se oferta e OE "██████" shpk është anomalisht e ulët, nuk qëndron, pasi është ajo e OE "██████" shpk për vlerën 5,209,408 leke pa tvsh dhe KVO nuk është shprehur për këtë fakt.

Lidhur me kriteret e sipërcituara objekt ka qenë dhe ankesa e subjektit MANE/S shpk datë 31.12.2015 ku kthimi i pëgjigjes datë 7.01.2016 nga bashkia Këlcyrë nuk ka qenë e argumentuar.

**b.** Për parregullsitë e konstatuara në klasifikimin, s'kualifikimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit "Skema ujitjes Ballaban(ujitja e fushës Ballaban rehabilitimi i pjesshëm), Bashkia Këlcyrë" për vitin 2016, çka ka krijuar mos efektivitet në vlerën 1,321,200 lekë.

**11. M.M.** juriste e bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e kryetares të njësisë të prokurimit,

**12. R.A.** nënkryetar i bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e anëtarit të njësisë të prokurimit,

**13. J.N.** specialist i urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit

**për shkeljet e përbashkëta, si më poshtë:**

-Për shkelje në hartimin e disa kriteret të vecanta të kualifikimit, në procedurat e prokurimit, në objektin "Sistemim asfaltim unaza Këlcyrë faza e II" Bashkia Këlcyrë, për vitin 2015, pasi njësia e prokurimit këto kriteret të vecanta kualifikimi i ka formuluar të pasakta, të cilat kanë ndikuar në eliminimin e operatorëve ekonomik, konkretisht:

-kërkohet numëri i fuqisë punëtore për 2 vjet (për periudhën janar 2014 deri në nëntor 2015), në vend të 3 viteve, siç kërkohet xhiro vjetore dhe shlyerja e taksave vendore për 3 vitet.

-kërkohet në kriteret për kualifikim kategori të cilat nuk kanë lidhje me objektin që prokurohet, konkretisht: kategoria NS-18 A ka të bëjë me punime topogjeodezike, kategoria NP-12 A ka të bëjë me punime të inxhinierise mjedisit, kategoria NP-11 A ka të bëjë me ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatoreve etj,

-nuk është vendosur kushti për stafin inxhiniero-teknik, për profesionin e tyre dhe sa duhen, në përputhje me llojin e punimeve,

-kërkohet makineri të ndryshme tek kriteret për kualifikim tek mjete e makineri në dispozicion, por nuk kërkohet "makineria Rul" për ngjeshjen e shtresave, për zërin e punës sipas preventivit të miratuar "shtresë çakulli 960 m2 me t=20 cm e përhapur dhe ngjeshur me makineri".

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 15, 26/5, 28/2/4/ç/5/c e ç, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar neni 45, me kërkesat e VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu II, pika 2.

### **Komuna Ballaban**

**14. A.D.** ish-kryetar i komunës Ballaban, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor,

**15. Dh.A.** ish-përgjegjëse e financës të komunës Ballaban, në cilësinë e kryetares të KVO,

**16. A.Sh.** inspektor i tatim-taksave vendore të komunës Ballaban, në cilësinë e antarit të KVO,

**17. F.Ç.** inspektor i zyrës të urbanistikës dhe arshivës të komunës Ballaban, në cilësinë e antarit të KVO,

për shkeljet e përbashkëta, si më poshtë:

**a.** Për shkelje në procedurat e prokurimit, në objektin "Urë Autobeton Arme Vinokashi ish-komuna Ballaban Këlcyrë" për vitin 2014, me vlerë kontrate 1,978,224 lekë pa tvsh, procedura kërkese me propozim, tender i zhvilluar në datë 13.06.2014, kontrata datë 11.07.2014 me vlerë 1,969,856 lekë pa tvsh, afati i realizimit 1 muaj, diferenca nga fondi limit 9,476 lekë,

KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues për vlerën 1,968,748 pa tvsh operatorin ekonomik "██████" shpk, pasi nuk plotëson këto kriteret të veçanta të kualifikimit, sa vijon:

-nuk plotëson numërin e punonjësve për disa muaj për periudhën e 4 mujorit III 2012 dhe 7 mujorit 2013 ku disponohen 15-16 veta nga 18 që duhen për çdo muaj, sipas vertetimeve nr. 1140/1, datë 13.5.2014, nr. 3730, datë 13.5.2014 të Drejtorisë Rajonale Sigurimeve Shoqërore, në kundërshtim me DST, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” nën pika 2.3 ”Kapaciteti teknik”.

-mungon në listpagesat emri i drejtuesit teknik të shoqërisë ( ), në kundërshtim me DST, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” nën pika 2.3 ”Kapaciteti teknik”.

-nuk plotëson kriterin “makineritë në dispozicion” pasi mungon mjete “Fadromë”, në kundërshtim me kërkesat e DST, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” nën pika 2.3 ”Kapaciteti teknik”.

- nuk ka paraqitur dokumentin e pronësisë për 4 betoniere, pasi nuk pasqyrohen në inventarin fizik dhe në kontabilitet si dhe në pasqyrat e shtesave e pakësimeve të bilancit të vitit 2013.

-nuk ka leje transporti nga bashkia Përmet për mjetet me targa TR 0095506, TR 0040794 dhe PR0000829, në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit.

-Në licencën profesionale të shoqërisë mungon kategoria NP-5 B ka të bëjë me “Punime nëntokësore, ura e vepra arti” e cila ka lidhje me objektin, kategori të cilën padrejtësisht NJP nuk e ka përfshirë në Kriteret e veçanta të kualifikimit .

-vërtetimet datë 12.5.2014 për shlyerjen e taksave vendore për vitet 2013 dhe 2014 është i parregullt, pasi mungon nënshkrimi dhe vula e titullarit bashkisë Përmet dhe protokollimi i tyre, në kundërshtim me DST, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” nën pika 2,1.a.

Mos plotësimi i kërkesave të mësipërme nga operatori i shpallur fitues “ ” shpk, bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 46 dhe 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Për rrjedhojë operatori ekonomik “ ” shpk duhet të ishte s`kualifikuar dhe tenderi duhet të ishte përsëritur.

**b.** Për mos zhvillim tenderi për shërbime publike në 2 raste për vitin 2013, për vlera mbi kufirin ligjor, në ish-komunën Ballaban, pasi është përdorur procedura e drejtpërdrejtë me vlera të vogla, për objektet “Rehabilitimin e rrugës Poste e vjetër-Karat” me vlerën 1,100,000 lekë dhe “Shpenzime për mirëmbajtje rruge” me vlerën 774,810 lekë, shërbime këto të kryera brenda vitit kalendarik dhe nga i njëjti subjekt, sipas urdhër shpenzimeve: nr. 137, datë 3.7.2013, nr. 140, datë 3.7.2013 dhe nr. 248, datë 27.11.2013, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 me kreun II dhe IV shkronja C etj.

**18. F.L.** inspektor i zyrës ndihmës ekonomike të komunës Ballaban, **në cilësinë e anëtarit të njësisë të prokurimit,**

**19. P.P.** juriste e jashtme e komunës Ballaban, **në cilësinë e anëtarit të njësisë të prokurimit,**

**20. E.B.** inspektor i tatim-taksave vendore dhe magazinier i Komunës Ballaban, **në cilësinë e anëtarit të njësisë të prokurimit,**

për shkeljet e përbashkëta, si më poshtë:

Nga auditimi mbi zbatimin e procedurës të prokurimit, në objektin “Urë Autobeton Arme Vinokashi ish-komuna Ballaban Këlcyrë” për vitin 2014, u konstatua se: Njësia e prokurimit disa kriteret të përgjithshme dhe të veçanta kualifikimi nuk i ka hartuar të sakta, të cilat kanë ndikuar në kualifikimin e padrejtë të ofertës fituese, konkretisht:

-NJP ka kërkuar disa kategori në licencën profesionale të shoqërisë që nuk kanë lidhje me objektin, për ekzekutimin e punëve në objekt, përkatësisht: kategoria NS-8 A, NS-7 A, NP-7 A, ndërsa nuk ka kërkuar kategorinë NP-5 B e cila ka lidhje me objektin “ Punime nëntokësore, ura e vepra arti ”.

-NJP nuk ka kërkuar vërtetimet për shlyerjen e taksave vendore për 3 vitet e mëparshme, por është mjaftuar me 2 vitet 2013 dhe 2014.

## **Komuna Deshnice**

**21. B.F. në cilësinë e ish-titullarit të Autoritetit Kontraktor** ish-Komuna Deshnice, për shkeljet e mëposhtme:

- Nga auditimi i dy procedurave të prokurimit me objekt “Mirëmbajtje Objektsh Komuna Deshnice” dhe “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” zhvilluar në të njëjtën datë dhe orë 04.07.2014 ora 9:00, dhe Raporti Përmbledhës me po të njëjtën datë 16.07.2014, në të cilat KVO, ka klasifikuar e shpallur fitues dhe më vonë ish-titullari ka lidhur kontrata me të njëjtin OE “██████████”. Sipas dokumentacionit të paraqitur në tender dhe në faqen app.gov.al, rezultojnë se ky OE, për disponimin e makinerive, sipas deklaratës së shtojcës së DT, dhe dokumentacionit vërtetues ka paraqitur të njëjtat makineri në të dy tenderat, dhe nuk ka fuqi punëtore të mjaftueshme për kryerjen e punimeve në dy objekte të ndryshme. Titullari i AK Bujar Fezga nuk duhej të lidhte kontratë me OE “██████████” në një nga procedurat e sipër trajtuara, për arsye se ky OE nuk e plotëson numrin e fuqisë punëtore si dhe kërkesat e DST për makineritë e pajisjet, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 4, “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, pika “ç”.

- Në dy procedurat e sipër trajtuar Titullari Autoriteti Kontraktor nuk ka miratuar dokumentet standarte të tenderit (DST) dhe ka lejuar vazhdimin e procedurës prokurimit pa u firmosur këto dokumente nga një anëtarë i njësies prokurimit, konkretisht nga juristi Patriot Mucaj (pavarësisht se emri i tij gjendet në sistem), në kundërshtim me VKM nr.1 datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu V, “Zhvillimi i procedurave” pika 1, si dhe neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**22. G. K, jurist i jashtëm, në cilësinë e juristit të njësies prokurimit,**

- **A.L. përgjegjësi shërbimeve, në cilësinë anëtarit të njësies prokurimit**

**23. P.J. topografi komunës, në cilësinë anëtarit njësies prokurimit.**

për shkeljet e përbashkëta si më poshtë:

**a.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundishte”, (Njësia Administrative Deshnice) me fond limit 44.449.531 lekë, procedurë e hapur, të vitit 2013, rezultoi se:

- NJHDT disa kritere të veçanta kualifikimi i ka formuluar në mënyrë jo të qartë dhe nuk i ka argumentuar ato, të cilat nuk janë objekt i kontratës, konkretisht: Numri i fuqisë punëtore mbi 30 punonjës nuk argumentohet për periudhën 60 ditore të realizimit të kontratës, pasi kontrata mund të realizohej me më pak punonjës krahasuar me punimet e parashikuara në preventiv, ku një përqindje të lartë të zbatimit të kontratës e zënë punimet me makineri dhe numri 30 i punonjësve nuk është i domosdoshëm,

- Për kategoritë NP 1 dhe NP 5 është kërkuar niveli B, të cilat mbas shtojcës së modifikimit të DST niveli i këtyre kategorive ndryshohet në A, në një kohë që duhet të ishte niveli B, veprim në pajtueshmëri me nenet 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

- NJP ka ndryshuar DST pa datë, pa nr. prot, dhe pa miratimin e titullarit mbi “Modifikimin dhe Ndryshimin e DST”,

**b.** Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Naftë” në vitin 2013, me fond limit 680,000 lekë, procedurë kërkesë për propozim-mallra, fitues “██████████” shpk, ish-Komuna Deshnice rezultoi se:

- në hartimin e kriterëve për kualifikim nuk është zbatuar VKM nr.1, datë 10.01.2007, Kreu III “Dokumentet e tenderit” pika 3, germa (b),

- nuk ka kërkuar kopje të një apo më shumë bilanceve të vërtetuara nga autoritetet përkatëse, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, Kreu III “Dokumentet e tenderit” pika 3 “Informacione të veçanta” germa (b), nënpika (i).

*Përveç sa më sipër G.K. paraqet edhe shkeljet sa vijon:*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundishte”, e vitit 2013 (ish-Komuna Deshnice), rezultoi se: Është publikuar në faqen e APP një preventiv i pa miratuar, me ndryshime nga projekti dhe preventivi miratuar. Ky preventiv është korrigjuar padrejtësisht në momentin e ngarkimit elektronik nga juristi i njësisë së prokurimit si person i autorizuar nga titullari për publikimin e DST në sistem, (edhe sipas deklaratës nga vetë juristi Gentian Kukureci). Konkretisht: zëri 3.226/1 (Shtrese asfaltobetoni 4 cm rruge) ka një rritje prej 5,400 m<sup>2</sup> (9300-3900) të volumit të punimeve, pasi në preventivin e miratuar (gjendur në dosje) zëri 3.226/1 “Shtrese asfaltobetoni 4 cm rruge” është 3,900 m<sup>2</sup>, ndërsa në preventivin pa çmime të publikuar në faqen e APP-s ky zë paraqitet 9,300 m<sup>2</sup>, çka do të thotë një shtesë fiktive në volumin e zërit Shtrese asfaltobetoni 4 cm rruge prej 5,400 m<sup>2</sup> (9300 m<sup>2</sup> – 3,900 m<sup>2</sup>). Pra vetëm si pasojë e këtij ndryshimi, është zhvilluar një procedurë prokurimi me një fond limit prej 4,584,600 lekë më pak nga vlera e nevojshme për tu vënë në dispozicion. Nga këto veprime dhe mosveprime janë preventivuar dhe situacionuar volume tepër dhe likuiduar volume të pakryera në fakt (trajtuar më hollësisht në pikën e auditimit të zbatimit të kontratave). Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Neni 41, pika. 1, dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu III “Dokumentet e tenderit” pika 1/a, Kreu V “Zhvillimi procedurave” pika 1 dhe 2.

**24. E.Z.** punonjës i gjendjes civile Njësia Administrative Deshnice, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**25. A.M.** ish-përgjegjësja personelit ish-komuna Deshnice, në cilësinë e anëtares KVO, për shkeljet e përbashkëta si më poshtë:

**a.** Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Naftë” në vitin 2013 në ish-Komnën Deshnice, me fond limit 680,000 lekë, fitues OE “██████” shpk me vlerë 680,000 lekë pa tvsh, u konstatua se: KVO nuk ka anuluar tenderin, pasi OE shpallur fitues nuk ka plotësuar kërkesat e veçanta të kualifikimit, konkretisht sa vijon:

- nuk ka paraqitur vërtetimin nga dega e tatim taksave për xhiron vjetore të realizuar në vitin 2011 dhe 2012, në kundërshtim me DST, 2.2 “kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika (b),

- nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore në kundërshtim me DST, 2.2 “kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika (c),

- nuk ka paraqitur leje tregtimi ose autorizimin për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga organet përkatëse, në kundërshtim me DST, 2.3 “kapaciteti teknik” pika (2),

- nuk ka paraqitur një fletë analizë të lëshuar nga një laborator i certifikuar, në kundërshtim me DST, 2.3 “kapaciteti teknik” pika (3),

- nuk ka paraqitur një dokument ku të vërtetojnë se nuk është dënuar me vendim gjykate, që lidhet me aktivitetin profesional të lëshuar nga QKR, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar “Për Prokurimin Publik” Kreun V, neni 45, pika 3/a,

- nuk ka paraqitur ekstraktin historik të QKR, në kundërshtim me DST “kriteret e përgjithshme të kualifikimit” pika 3.

Veprime në kundërshtim me nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3 të Ligjit nr. 9643, “Për prokurimin publik”, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**b-** Nga auditimi i procedurave të prokurimit në ish- Komunën Deshnice, rezultoi se janë zhvilluar 2 procedura prokurimi “Mirëmbajtje Objektesh Komuna Deshnice” dhe “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” me fond limit respektivisht 1.999.748 lekë dhe 1.245.400 lekë në të njëjtën datë dhe orë 04.07.2014 ora 9:00, dhe Raporti Përmbledhës

me po të njëjtën datë 16.07.2014, në të cilat KVO, ka klasifikuar e shpallur fitues të njëjtin OE "██████". Sipas dokumentacionit të paraqitur në tender dhe në faqen app.gov.al, rezulton se ky OE, për disponimin e makinerive, sipas deklaratës së shtojcës së DT, dhe dokumentacionit vërtetues ka paraqitur të njëjtat makineri në të dy tenderët, dhe nuk ka fuqi punëtore të mjaftueshme për kryerjen e punimeve në dy objekte të ndryshme. KVO, e cila është e njëjtë për të dy procedurat, nuk duhej të shpallte fitues "██████" në një nga procedurat e sipër trajtuara, pasi nuk e plotëson numrin e fuqisë punëtore si dhe kërkesat e DST për makineritë e pajisjet, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 4, "Hapja dhe vlerësimi i ofertave", pika "ç".

c- në tenderin "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundishte", të kryer në vitin 2013, me fond limit 44.449.531 lekë, procedurë prokurimit e hapur, fitues BOE "██████" me vlerë më të lartë, rezultoi se: KVO ka shpallur padrejtësisht fitues BOE "██████" pasi kanë mangësi në plotësimin e kriterëve të kërkuara në DST, duke mbajtur qëndrim me dy standarte, pasi edhe BOE shpallur fitues "██████" me vlerë më të lartë nuk ka paraqitur vërtetim për taksat vendore nga të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit të tij dhe nuk është konstatuar, arsye për të cilën është skualifikuar edhe OE me vlerë më të vogël se fituesi. Nga s`kualifikimi i padrejtë i OE me vlerë më të ulët KVO i ka shkaktuar buxhetit të shtetit 574,700 lekë dëm ekonomik. Veprime në papajtueshmëri me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, gërma *d* dhe *dh*, Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c, dhe nenin 20, "Mosdiskriminimi".

## **26. R.S. ish-përgjegjëse financës ish-Komuna Deshnice, në cilësinë e anëtares Njësisë prokurimit dhe KVO, për shkeljet e mëposhtëme:**

a- në cilësinë e anëtares së KVO. Në tenderin me objekt "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundishte", të kryer në vitin 2013, me fond limit 44.449.531 lekë, procedurë prokurimit – e hapur, fitues BOE "██████" me vlerë më të lartë, rezultoi se: KVO ka shpallur padrejtësisht fitues BOE "██████" pasi kanë mangësi në plotësimin e kriterëve të kërkuara në DST, duke mbajtur qëndrim me dy standarte, pasi edhe BOE shpallur fitues "██████" me vlerë më të lartë nuk ka paraqitur vërtetim për taksat vendore nga të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit të tij dhe nuk është konstatuar, arsye për të cilën është skualifikuar edhe OE me vlerë më të vogël se fituesi. Nga s`kualifikimi i padrejtë i OE me vlerë më të ulët KVO i ka shkaktuar buxhetit të shtetit 574,700 lekë dëm ekonomik. Veprime në papajtueshmëri me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, gërma *d* dhe *dh*, Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c, dhe nenin 20, "Mosdiskriminimi".

- Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje Naftë" në vitin 2013 në ish-Komnën Deshnice, me fond limit 680,000 lekë, fitues OE "██████" shpk me vlerë 680,000 lekë pa tvsh, u konstatua se: KVO nuk ka anuluar tenderin, pasi OE shpallur fitues nuk ka plotësuar kërkesat e veçanta të kualifikimit, konkretisht sa vijon:

- nuk ka paraqitur vërtetimin nga dega e tatim taksave për xhiron vjetore të realizuar në vitin 2011 dhe 2012, në kundërshtim me DST, 2.2 "kapaciteti ekonomik dhe financiar" pika (b),
- nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore në kundërshtim me DST, 2.2 "kapaciteti ekonomik dhe financiar" pika (c),
- nuk ka paraqitur leje tregtimi ose autorizimin për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga organet përkatëse, në kundërshtim me DST, 2.3 "kapaciteti teknik" pika (2),
- nuk ka paraqitur një fletë analizë të lëshuar nga një laborator i certifikuar, në kundërshtim me DST, 2.3 "kapaciteti teknik" pika (3),

- nuk ka paraqitur një dokument ku të vërtetojnë se nuk është dënuar me vendim gjykatë, që lidhet me aktivitetin profesional të lëshuar nga QKR, në kundërshtim me Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar “Për Prokurimin Publik” Kreun V, neni 45, pika 3/a,  
- nuk ka paraqitur ekstraktin historik të QKR, në kundërshtim me DST “kriteret e përgjithshme të kualifikimit” pika 3.

Veprime në kundërshtim me nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3 të Ligjit nr. 9643, “Për prokurimin publik”, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**b- në cilësinë e anëtarës njësisë prokurimit.** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “Mirëmbajtje Objektesh Komuna Dishnice” dhe “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj”, (Njësia Administrative Deshnice) respektivisht me fond limit 1.999.748 lekë dhe 1.245.400, kërkesë për propozim në vitin 2014, rezultoi se:

NJHDT e cila është e njëjtë për të dy tenderat nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim dhe DT nuk i ka hartuar konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, konkretisht më poshtë:

**a-** në tenderin me objekt “Rikonstruksion I Rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” njësia prokurimit ka kërkuar kategori në licencën profesionale të shoqërisë që nuk janë objekt i kontratës, pasi nuk janë parashikuar në preventivin, konkretisht: NP-7A -Ujsjellësa, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje dhe NS-7A - Barriera dhe mbrojtje rrugore,

**b-** në te dy tenderat nuk argumentohet kërkesat për numrin e fuqisë punëtore i të paktën 20 punonjësve për periudhën qershor 2011-prill 2014.

**c-** nuk ka gjetur zbatim VKM nr.379, datë 11.06.2014 pasi nuk është kërkuar “Vërtetimi për shlyerjen e energjisë elektrike”,

**27. P.M.** jurist i jashtëm, **në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit** në ish-Komunën Deshnice, për shkeljet e mëposhtme:

Nga auditimi i dy procedurave të prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” dhe “Mirëmbajtje Objektesh Komuna Deshnice” të zhvilluar në të njëjtën datë dhe orë 04.07.2016 ora 9:00, rezultoi se: juristi P.M. (*i cili ka emrin në sistem, gjithashtu edhe si person i autorizuar nga titullari për hedhjen e dokumentave në sistem*) nuk ka zbatuar urdhërin e prokurimit dhe urdhërin e titullarit, pasi nuk ka firmosur dy procesverbalet mbi “Për përgatitjen dhe paraqitjen e DST” respektivisht më datë 18.06.2014 dhe 19.06.2014. Theksojmë se në dosje nuk ndodhet relacion apo shpjegim për arsyen e mos-firmosjes të DST nga juristi. Veprime në kundërshtim me VKM nr.1 datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu V, “Zhvillimi i procedurave” pika 1.

**28. F.S.** inspektor tatimesh ish-Komuna Deshnice, **në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit**, për shkeljet e mëposhtme:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “Mirëmbajtje Objektesh Komuna Dishnice” dhe “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj”, (Njësia Administrative Deshnice) respektivisht me fond limit 1.999.748 lekë dhe 1.245.400, kërkesë për propozim në vitin 2014, rezultoi se:

NJHDT e cila është e njëjtë për të dy tenderat nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim dhe DT nuk i ka hartuar konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, konkretisht më poshtë:

**a-** në tenderin me objekt “Rikonstruksion I Rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” njësia prokurimit ka kërkuar kategori në licencën profesionale të shoqërisë që nuk janë objekt i kontratës, pasi nuk janë parashikuar në preventivin, konkretisht: NP-7A -Ujsjellësa, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje dhe NS-7A - Barriera dhe mbrojtje rrugore,

b- në te dy tenderat nuk argumentohet kërkesat për numrin e fuqisë punëtore i të paktën 20 punonjësve për periudhën qershor 2011-prill 2014.

c- nuk ka gjetur zbatim VKM nr.379, datë 11.06.2014 pasi nuk është kërkuar “Vërtetimi për shlyerjen e energjisë elektrike”,

### **29. H.S. punonjës i shërbimeve ish-Komuna Dëshnice, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e mëposhtme:**

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit në ish-Komunën Dëshnice, rezultoi se janë zhvilluar 2 procedura prokurimi “Mirëmbajtje Objektesh Komuna Dëshnice” dhe “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” me fond limit respektivisht 1.999.748 lekë dhe 1.245.400 lekë në të njëjtën datë dhe orë 04.07.2014 ora 9:00, dhe Raporti Përmbledhës me po të njëjtën datë 16.07.2014, në të cilat KVO, ka klasifikuar e shpallur fitues të njëjtin OE “██████████”. Sipas dokumentacionit të paraqitur në tender dhe në faqen app.gov.al, rezulton se ky OE, për disponimin e makinerive, sipas deklaratës së shtojcës së DT, dhe dokumentacionit vërtetues ka paraqitur të njëjtat makineri në të dy tenderët, dhe nuk ka fuqi punëtore të mjaftueshme për kryerjen e punimeve në dy objekte të ndryshme. KVO, e cila është e njëjtë për të dy procedurat, nuk duhej të shpallte fitues “██████████” në një nga procedurat e sipër trajtuara, pasi nuk e plotëson numrin e fuqisë punëtore si dhe kërkesat e DST për makineritë e pajisjet, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 4, “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, pika “ç”.

### **C.2. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)**

Bazuar në nenin 13, pika 3/a, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, përjashtimin për 1 vit të OE “██████████” shpk për deklarime të rreme, sa vijon:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit në objektet “Mirëmbajtje objektesh ish-komuna Dëshnice” dhe “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” me fond limit respektivisht 1,999,748 lekë dhe 1,245,400 lekë, kërkesë për propozim në vitin 2014, u konstatua se 2 tenderat janë zhvilluar në të njëjtën datë 4.7.2014 dhe në të njëjtën orë 9:00 si dhe me të njëjtën datë janë mbajtur raportet përmbledhëse 16.07.2014, ku KVO ka klasifikuar e shpallur fitues të njëjtin OE “██████████”. Dokumentacioni i paraqitur në faqen e APP nga OE shpallur fitues, për disponimin e makinerive sipas deklaratës së shtojcës DT dhe dokumentacionit vërtetues, rezulton se OE ka paraqitur të njëjtat makineri në 2 tenderat, duke paraqitur deklaratë të rreme, në kundërshtim me Dokumentet Standarte.

### **C.3. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Këlcyrë.**

Referuar gjetjeve të konstatuara në fushën e ndërtimeve përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet përkatëse, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 15 germa (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe bazuar në nenin 5/b, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” dhe nenin 15 “Sanksionet”, dhe 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Vendor i Mbrojtjes Territorit (IVMT) Bashkia Këlcyrë, të vlerësojë shkeljet

e konstatuara, duke vendosur dënimin me gjobë **për 4 persona**, për shkeljen e konstatuar si më poshtë:

**1. Për Ing. A.P.** në masën **500,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara me pasojë **dëm ekonomik** në vlerën **5,521,719 lekë** pa tvsh ndaj buxhetit të shtetit si dhe preventivuar jo në përputhje me projektin e miratuar të zbatimit dhe me manualin teknik të çmimeve në fuqi vlera **12,467,282 lekë** pa t.v.sh të detajuara këto si më poshtë:

**Nën cilësinë e projektuesit** në objektin:

**a.**“Rikonstruksion i rrugës së fshatit Katundishtë (faza 2)” Deshnicë, janë preventivuar jo në përputhje me projektin e miratuar të zbatimit dhe me manualin teknik të çmimeve në fuqi vlera **12,467,282 lekë** pa t.v.sh.

Kjo diferencë ka ardhur si pasojë e mos paraqitjes së emërtimeve të saktë të zërave të punimeve si dhe volumeve përkatëse të tyre në përputhje me projektin e miratuar të zbatimit. Këto veprime bien në kundërshtim me nenin 4 dhe 5 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Vendimin nr. 514 datë 15.08.2007“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9.

**Nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve** në objektet:

**a.**“Rikonstruksion i rrugës së fshatit Katundishtë (faza 2)” Deshnicë, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën **4,857,219 lekë** pa tvsh;

**b.**“Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj”, Këlcyrë me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën **664,500 lekë** pa tvsh;

Për këto dy objekte janë firmosur situacione me punime të pakryera në fakt apo të pa ndryshuara sipas zërit të kryer në përputhje me analizën e parashikuar në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Këto veprime këto bien në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, me kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 05.06.2013 të lidhur mes ish-titullarit të AK dhe BOE “██████████” sh.p.k dhe “██████████” sh.p.k pika 1 dhe pika 5.2, kontratën datë 05.06.2013 të lidhur mes ish-titullarit të AK dhe ing. A.P. për mbikëqyrjen e punimeve e konkretisht pika 1, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 30.07.2014 të lidhur mes ish-titullarit të AK dhe OE “██████████” sh.p.k, kontratën datë 30.07.2014 të lidhur mes ish-titullarit të AK dhe ing. A.P. për mbikëqyrjen e punimeve, pika 2 si dhe me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9.

**2. Për Ing. S.Sh.** në masën **200,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara me pasojë **dëm ekonomik** në vlerën **8,092,145 lekë** pa tvsh të detajuara këto si më poshtë:

**Nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve** në objektin:

**a.**“Skema Ujitëse Ballaban, Ujitja e fushës Ballaban”, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **6,392,567 lekë** pa tvsh;

**Nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve** në objektin:

**a.**“Sistemim Asfaltim Unaza Këlcyrë Qendër-Faza e II-të” Këlcyrë, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,699,578 lekë** pa tvsh;

Për këto dy objekte janë firmosur situacione dhe janë kolauduar punime të pakryera në fakt apo të pa ndryshuara sipas zërit të kryer në përputhje me analizën e parashikuar në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Këto veprime këto bien në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. – prot. datë 31.05.2016 të lidhur mes titullarit të AK Bashkia Këlcyrë dhe BOE “██████████” sh.p.k dhe “██████████” sh.p.k, kontratën datë 31.05.2016 të lidhur mes titullarit të AK Bashkia Këlcyrë dhe ing. S.Sh. për mbikëqyrjen e punimeve,

konkretisht pika 2, pika 3, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 25.01.2016 të lidhur mes titullarit të AK dhe BOE “██████████” sh.p.k dhe “██████████” sh.p.k, kontratën datë 25.01.2016 të lidhur mes titullarit të AK dhe ing. K.I. për mbikëqyrjen e punimeve, kontratën datë 10.06.2016 të lidhur mes titullarit të AK dhe ing. S.Sh. për kolaudimin e punimeve, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 3 dhe pikat 8.1 e 8.3. si dhe me Vendimin nr. 514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9.

**3. Për Ing. L.Th.** në masën **200,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara me pasojë **dëm ekonomik** në vlerën **11,914,286 lekë** pa tvsh ndaj buxhetit të shtetit të detajuara këto si më poshtë:

**Nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektet:**

**a.** “Skema Ujitëse Ballaban, Ujitja e fushës Ballaban”, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **6,392,567 lekë** pa tvsh;

**b.** “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Katundishtë (faza 2)” Deshnicë, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën **4,857,219 lekë** pa tvsh;

**c.** “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj”, Këlcyrë me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën **664,500 lekë** pa tvsh;

Për këto tre objekte janë kolauduar punime të pakryera në fakt apo të pa ndryshuara sipas zërit të kryer në përputhje me analizën e parashikuar në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Këto veprime këto bien në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 31.05.2016 të lidhur mes titullarit të AK Bashkia Këlcyrë dhe BOE “██████████” sh.p.k dhe “██████████” sh.p.k, kontratën datë 31.05.2016 të lidhur mes titullarit të AK Bashkia Këlcyrë dhe ing. S.Sh. për mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht pika 2, pika 3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 05.06.2013 të lidhur mes ish – titullarit të AK dhe BOE “██████████” sh.p.k dhe “██████████” sh.p.k pika 1 dhe pika 5.2, kontratën datë 05.06.2013 të lidhur mes ish-titullarit të AK dhe ing. A.P. për mbikëqyrjen e punimeve e konkretisht pika 1, kontrata datë 29.04.2015 e lidhur mes ish-titullarit të AK për kolaudimin e punimeve, konkretisht paragrafi i parë si dhe me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 30.07.2014 të lidhur mes ish -titullarit të AK dhe OE “██████████” sh.p.k, kontratën datë 30.07.2014 të lidhur mes ish- titullarit të AKr dhe ing. A.P. për mbikëqyrjen e punimeve, pika 2, kontratën me datë 29.04.2015 të lidhur mes ish-titullarit të AK si dhe ing. L.Th. për kolaudimin e punimeve, pika 1.

**4. Për Ing. K.I.** në masën **100,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara me pasojë **dëm ekonomik** në vlerën **2,325,522 lekë** pa tvsh të detajuara këto si më poshtë:

**Nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin:**

**a.** “Sistemim Asfaltim Unaza Këlcyrë Qendër-Faza e II-të” Këlcyrë, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,699,578 lekë** pa tvsh;

**Nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektin:**

**a.** “Sistemim Asfaltim Unaza Këlcyrë Qendër-Faza e I-rë” Këlcyrë, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **625,944 lekë** pa tvsh;

Për këto tre objekte janë kolauduar punime të pakryera në fakt apo të pa ndryshuara sipas zërit të kryer në përputhje me analizën e parashikuar në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Këto veprime këto bien në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. -prot. datë 30.07.2014 të lidhur mes titullarit të AK dhe OE “██████████” sh.p.k,

kontratën datë 15.07.2014 të lidhur mes titullarit të AK dhe subjektit për mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht pikat 2 dhe 3, paragrafi i dytë, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 25.01.2016 të lidhur mes titullarit të AK dhe BOE “██████████” sh.p.k dhe “██████████” sh.p.k, kontratën datë 25.01.2016 të lidhur mes titullarit të AK dhe ing. K.I. për mbikëqyrjen e punimeve, kontratën datë 10.06.2016 të lidhur mes titullarit të AK dhe ing. S.Sh. për kolaudimin e punimeve, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, Pika 9, paragrafi i dytë dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 3 dhe pikat 8.1 e 8.3.

## **D. MASA DISIPLINORE**

### **D.1. Për nëpunësit të cilët janë pjesë e shërbimit civil.**

Mbështetur në nenin 15 shkronja (c) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, bazuar në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 germa g dhe k të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë** që ti kërkojë komisionit disiplinor, pranë institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”**, deri në **“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”**, parashikuar në nenin 58 shkronja “b” dhe “c”, për **1 punonjës**, si më poshtë:

**1. Xh.D.** me detyrë ish-përgjegjës i zyrës financës (2013-shtator 2015) aktualisht përgjegjës i zyrës së ndihmës ekonomike të bashkisë Këlcyrë, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH për vlerën 4,096,510 lekë, sipas shkresave nr. 434/53, datë 01.07.2013 dhe nr. 351/68, datë 2.2.2011,

-Për mos shfrytëzimin të pronave që nga viti 2008, të cilat kanë kaluar në përdorim të ish-Bashkisë dhe janë jashtë kontrollit dhe administrimit të së drejtës së përdorimit, pa u vënë në efikasitet, pasi nuk janë dhënë me qira, çka ka krijuar efekte financiare për Buxhetin e Bashkisë në vlerën 10,894,800 lekë të ardhura të munguara, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014.

-Për mos monitorim të kontratës së qirasë lidhur midis Bashkisë Këlcyrë dhe Kompanisë ██████████, dhe mos azhurnim të saktë të tarifës të vlerës së qirasë lek/ha/vit, çka krijuar efektin financiar në vlerën 2,825,634 lekë dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë, detyrim qiraje i pa arkëtuar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

-Për mos derdhje në buxhetin e shtetit, të tatimit në burim për të ardhurat nga qiratë në vlerën 419,500 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 33 germa “ë”, “pagesat për qiratë”.

-nuk ka kontabilizuar debitorët për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Këlcyrë në vlerën 7,673 mijë lekë, në kundërshtim me neni 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

## **D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neneve 11 dhe 12, të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave për **13 punonjës**, sa vijon:

### **“Zgjidhjen e Kontratës së Punës”, për 5 punonjës, si më poshtë:**

**2. A.P.** me detyrë përgjegjës i zyrës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk ka vepruar për të aplikuar gjoba, për rastet e shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimeve të kryera, për vendimet e marra për pezullim të punimeve të ndërtimit dhe për plotësim dokumentacioni tekniko ligjor, jo në përputhje me kërkesat e pikës 8/a të nenit 82, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin e zhvillimin territorit”, neni 52, pika 1, germa “e” dhe ligjit 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5 germa “b”.

-Nuk ka vepruar për të marrë vendime dhe për të aplikuar gjoba për shkeljet e konstatuara dhe të dokumentuara me proces verbale, jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, neni 52, pika 1, germa “e” dhe ligjit 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5 germa “b”.

-Nuk ka përcaktuar saktë llojin e shkeljes së konstatuar as edhe llojin e objektit të ndërtuar pa leje, gjatë kryerjes së inspektime në subjekte të ndryshme për ndërtimet pa leje, por vetëm është cituar në këto vendime, se “janë punime të ndryshme pa leje ndërtimi dhe janë në shkelje të ligjit për planifikimin e territorit”, në 13 vendime të marra, nga të cilat 4 vendime për pezullim të punimeve të ndërtimit dhe 9 vendime për plotësim dokumentacioni tekniko ligjor, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, neni 4, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, neni 14.

**3. A.L.** me detyrë specialist i emergjencave dhe kadastrës, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos hartimin e përmbledhëses dhe bashkimin e listave të aseteve të Bashkisë Këlcyrë dhe 3 Njësi Administrative ish-komunat, Dishnicë, Suk, Ballaban, për të përpiluar një pasqyrë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë, në kundërshtim me kërkesat e UM Financave nr. 30, datë 27.12.2011.

-Për mos menaxhim të mirë të situatës, në lidhje me asetet e paluajtshme që ka në pronësi dhe në përdorim si rezultat i mos regjistrimit të drejtave të pronësisë apo përdorimit, kryerjes jo në përputhje me përcaktimet ligjore të procesit të inventarizimit dhe marrjes së tyre në dorëzim, mos ushtrimit të kontroleve dhe saktësisimit të kufijve të pronave, numrave të pasurisë sipas zonave përkatëse kadastrale, mos shfrytëzimit të tyre në formën e qiradhënies, përfshi dhe tokat bujqësore të pandara në dispozicion, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjit nr. 33-2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inv. pronave paluajtshme dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

-Në cilësinë anëtarit njësisë prokurimit, në ish-Komunën Deshnice, me detyrë përgjegjësi shërbimeve, për shkeljet si më poshtë:

a. Në procedurën e prokurimit publik me objekt “Blerje Naftë” kërkesë për propozim Mallra, të vitit 2013 në ish-Komunën Deshnice, rezultoi se: në hartimin e kriterëve për kualifikim nuk është zbatuar VKM nr.1, datë 10.01.2007, Kreu III “Dokumentet e tenderit” pika 3, germa (b); nuk ka kërkuar kopje të një apo më shumë balanceve të vërtetuara nga autoritetet përkatëse, në

kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, Kreu III “Dokumentet e tenderit” pika 3 “Informacione të veçanta” germa (b), nënpika (i) dhe dokumentet e tenderit nuk janë miratuar nga titullari Autoritetit Kontraktor.

b. Në procedurën e prokurimit publik me objekt “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundishte” procedurë e hapur, të vitit 2013 në ish-Komunën Dëshnice, rezultoi se: Për kategoritë NP 1 dhe NP 5 është kërkuar niveli B, të cilat mbas shtojcës së modifikimit të DST niveli i këtyre kategorive ndryshohet në A, në një kohë që duhet të ishte niveli B, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

-Në cilësinë e kryetarit të KVO, për shkeljet në kualifikimin dhe shpalljen fitues të BOE “██████” shpk, pasi nuk plotëson 2 kritere, sipas procesverbalit datë 30.12.2015, çka ka krijuar vlerën 1,4 milion lekë mosefektivitet në fondet publike, në objektin “Sistemim asfaltim unaza Këlcyrë faza e II” Bashkia Këlcyrë, për vitin 2015.

**4. E.Z.** punonjës gjendjes civile Dëshnice, për shkeljet e mëposhtme:

**a-** Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Naftë” në vitin 2013 në ish-Komunën Dëshnice, ka kualifikuar dhe shpallur fitues padrejtësisht OE “██████” shpk, pasi ky OE nuk ka plotësuar kërkesat e veçanta të kualifikimit, konkretisht:

- nuk ka paraqitur vërtetimin nga dega e tatim taksave për xhiron vjetore të realizuar në vitin 2011 dhe 2012, në kundërshtim me DST, 2.2 “kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika (b),

- nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore në kundërshtim me DST, 2.2 “kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika (c),

- nuk ka paraqitur leje tregtimi ose autorizimin për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga organet përkatëse, në kundërshtim me DST, 2.3 “kapaciteti teknik” pika (2),

- nuk ka paraqitur një fletë analizë të lëshuar nga një laborator i certifikuar, në kundërshtim me DST, 2.3 “kapaciteti teknik” pika (3),

- nuk ka paraqitur një dokument ku të vërtetojnë se nuk është dënuar me vendim gjyqate, që lidhet me aktivitetin profesional të lëshuar nga QKR, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar “Për prokurimin publik” Kreun V, neni 45, pika 3/a,

- nuk ka paraqitur ekstraktin historik të QKR, në kundërshtim me DST “kriteret e përgjithshme të kualifikimit” pika 3.

Veprime në kundërshtim me nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3 e ligjit nr. 9643, “Për prokurimin publik”, datë 20.11.2006.

**b-** për kualifikimin e shpalljen fitues të BOE “██████”, në tenderin e vitit 2013, me objekt “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundishte”, me vlerë më të lartë të ofertës, në kushtet kur KVO ka përdorur 2 standarde në vlerësimin e ofertave pasi edhe BOE shpallur fitues ██████ nuk ka paraqitur vërtetim për taksat vendore nga të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit të tij dhe nuk është konstatuar nga KVO (arsye për të cilën edhe OE me vlerë më të vogël “██████” është skualifikuar nga gara), për më tepër BOE i shpallur fitues ka mangësi të tjera në plotësimin e kritereve të DST, çka ka shkaktuar vlerën 574,700 lekë dëm ekonomik. Në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa d dhe dh, Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, dhe nenin 20, “Mosdiskriminimi”.

**c-** në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit, për procedurat e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje Objektsh Komuna Dëshnice” dhe “Rikonstruksion I Rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj”, viti 2014 (ish-Komuna Dëshnice) respektivisht me fond limit 1.999.748 lekë dhe 1.245.400, kërkesë për propozim të vitit 2014, rezultoi se:

a-nuk ka gjetur zbatim VKM nr.379, datë 11.06.2014 pasi nuk është kërkuar “Vërtetimi për shlyerjen e energjisë elektrike”, b-nuk argumentohet kërkesa për numrin e fuqisë punëtore veprim në papajtueshmëri me pikën 3 të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për

Prokurimin Publik” i ndryshuar, c-njësia prokurimit ka kërkuar kategori në licensën profesionale të shoqërisë që nuk kanë lidhje me objektin pasi nuk janë parashikuar në preventivin e publikuar, përkatësisht: NP-7A- Ujsjellësa, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje, NS-7A, Barriera dhe mbrojtje rrugore. Veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, gërmat (c) (d) dhe (dh), nenin 20, Mosdiskriminimi”, VKM nr.1, datë 10.01.2007, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika 2 “hartimi dokumentave të tenderit” nën-pika (a).

**5. Dh.A.** me detyrë ish-përgjegjëse e financës të Komunës Ballaban, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos rakordim të shpenzimeve të karburantit për automjetin Benz të ish-komunës Ballaban, për periudhën datë 28.5 2016 deri më datë 12.7.2015, ku rezultoi diferenca tepër 674 litra naftë, për vlerën 121,320 lekë tejkalim normative të karburantit, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”.

-Për lejimin e kryerjes së shpenzimeve të karburantit dhe pjesëve të këmbimit pa efikasitet, pasi janë më të larta se vlera fillestare e makinës, për periudhën e 6-mujorit të parë 2015,

-Për mos marrjen e masave për arkëtimin e vlerës debitorë 326,252 lekë për 38 persona, sipas bilancit vitit 2015 të komunës Ballaban, pasi disa debitorë kanë patur mundësi arkëtimi sepse kanë qenë punonjës të komunës,

-Për mos kontabilizimin e debitorëve të taksave vendore për vlerën 16 milion lekë nga këto:13 milion lekë taksë toke +banese, 2,4 milion lekë taksë biznesi i vogël, 0,6 milion lekë tarife dru zjarri, uji pishëm dhe qira objekti etj,

-Për lejimin e pagesës për dieta të tepërta në vlerën 130,000 lekë dëm ekonomik, pasi dokumentacioni është i parregullt dhe i pa justifikuar për periudhën e vitit 2013 - korrik 2015, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”,

-Për lejimin e kryerjes të shpenzimit të paligjshëm, me rastin e festave të fund vitit ka për vlerën 33,330 lekë dëm ekonomik, për një koktej me pjesëmarrjen e 65 punonjësve të administratës dhe tjerë, sipas urdhër shpenzimit nr. 273, datë 23.12.2014, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

-Për lejimin e pagesës për vlerën 320,700 lekë dëm ekonomik, shpenzim për “riparime rrugësh brendshme Ballaban”, sipas urdhër shpenzimit nr. 112, datë 23.6.2015, pasi shpenzimi nuk është miratuar në Këshillin e Komunës dhe mungojnë dokumentet justifikuese.

-Për mos zhvillim tenderi për shërbime publike në 2 raste për vitin 2013, për vlera mbi kufirin ligjor, në ish-komunën Ballaban, pasi është përdorur procedura e drejtpërdrejtë me vlera të vogla, për objektet “Rehabilitimin e rrugës Poste e vjetër-Karat” me vlerën 1,100,000 lekë dhe “Shpenzime për mirëmbajtje rruge” me vlerën 774,810 lekë, shërbime këto të kryera brenda vitit kalendarik dhe nga i njëjti subjekt, sipas urdhër shpenzimeve: nr. 137, datë 3.7.2013, nr. 140, datë 3.7.2013 dhe nr. 248, datë 27.11.2013, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 me kreun II dhe IV shkronja C etj.

-Për shkeljen financiare në administrimin monetar të vlerës 1,100,000 lekë, pasi burim financimi me te drejte kthimi për një afat 2 vjeçar, ka qenë huaja e 1 personi privat, sipas mandatarkëtimit të ■ date 8.01.2013 dhe aktmarrëveshjes datë 15.01.2013, për “rehabilitimin e rrugës Poste e vjetër-Karat” për vitin 2013. Praktika dokumentare e këtij investimi është e parregullt dhe me mangësi dokumentare, pasi mungon projekti , situacioni, kontrata me kushtet përkatëse etj. Nuk është kontabilizuar dhe nuk është pasqyruar vlera 1,100,000 lekë e huas, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” dhe me UMF nr. 35, datë 5.11.2008 “Për huamarrjen e qeverise vendore” neni 11, pika 2.

**6. H.Sh.** me detyrë ish-përgjegjës i zyrës financës (tetor 2015-prill 2016), aktualisht llogaritar i financës të bashkisë Këlcyrë, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH për vlerën 4,096,510 lekë, sipas shkresave nr. 434/53, datë 01.07.2013 dhe nr. 351/68, datë 2.2.2011,

-Për mos administrimin e shërbimit të pastrimit të qytetit Këlcyrë për vitin 2015-2016, pasi paraqet kosto më të lartë se firma sipërmarrëse e pastrimit e cila e mbulonte këtë shërbim për vitin 2014, çka ka ndikuar negativisht në buxhetin e bashkisë për vlerën 2,2 milion lekë. Për mos kryerjen e analizës ek-financiare të shërbimit të pastrimit të qytetit nën administrimin e bashkisë, pasi nuk ka qenë me aktivitet krahasuar me sipërmarrjen private.

-Për mos administrimin nëpërmjet magazinës të 1 pompë uji për vlerën 300,000 lekë, sipas urdhër shpenzimit nr. 264, datë 29.10.2015 dhe faturës subjektit nr. 32, datë 16.10.2015, në kundërshtim me nenin 13 pika c të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për MFK” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Për mos shfrytëzimin të pronave që nga viti 2008, të cilat kanë kaluar në përdorim të ish-Bashkisë dhe janë jashtë kontrollit dhe administrimit të së drejtës së përdorimit, pa u vënë në efikasitet, pasi nuk janë dhënë me qira, çka ka krijuar efekte financiare për Buxhetin e Bashkisë në vlerën 10,894,800 lekë të ardhura të munguara, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014.

-Për mos monitorim të kontratës së qirasë lidhur midis Bashkisë Këlcyrë dhe Kompanisë ■■■■■, dhe mos azhurnim të saktë të tarifës të vlerës së qirasë lek/ha/vit, çka krijuar efektin financiar në vlerën 2,825,634 lekë dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë, detyrim qiraje i pa arkëtuar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

-Për mos derdhje në buxhetin e shtetit, të tatimit në burim për të ardhurat nga qiratë në vlerën 419,500 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 33 germa “ë”, “pagesat për qiratë”.

- Gjatë kryerjes së detyrës së ish-përgjegjës të financës dhe nëpunësit zbatues në ish-Komunën Sukë për periudhën 01.01.2013-30.09.2015:

a. nuk ka llogaritur dhe nuk ka paguar detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për pesë punonjës me kohë të pjesshme në vlerën 363,258 lekë në kundërshtim me nenin 2 dhe nenin 10 të ligjit nr. 7703, datë 12.05.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar.

b. ka lejuar kryerjen e shpenzimeve për dieta tepërta për 3 punonjës në vlerën 367,500 lekë, në mungesë të faturës tatimore me tvsh dhe argumentimit të qëllimit të shërbimit.

c. ka lejuar kryerjen e procedurës së prokurimit me vlera të vogla për karta rimbushëse të telefonisë celulare me pasojë krijimin e dëmit ekonomik në vlerën 150,000 lekë.

d- nuk ka kontabilizuar debitorët për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 8,605 mijë lekë.

-Në detyrën e ish përgjegjës të financës dhe nëpunësit zbatues në Bashkinë Këlcyrë për periudhën 01.10.2015-29.04.2016:

a. nuk ka kontabilizuar debitorët për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 2,516 mijë lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me neni 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për MFK”.

### **“Vërejtje me paralajmërim”, për 2 punonjës, si më poshtë:**

**7. R.A.** nënkryetar i bashkisë Këlcyrë, për shkeljet mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë të prokurimit, për shkelje në hartimin e disa kritere të vecanta të kualifikimit, në procedurat e prokurimit, në objektin “Sistemim asfaltim unaza Këlcyrë faza e II” Bashkia Këlcyrë, për vitin 2015, pasi njësia e prokurimit këto kritere të vecanta

kualifikimi i ka formuluar të pasakta, të cilat kanë ndikuar në eliminimin e operatorëve ekonomik, konkretisht:

-kërkohet numëri i fuqisë punëtore për 2 vjet (për periudhën janar 2014 deri në nëntor 2015), në vend të 3 viteve, siç kërkohet xhiro vjetore dhe shlyerja e taksave vendore për 3 vitet.

-kërkohet në kriteret për kualifikim kategori të cilat nuk kanë lidhje me objektin që prokurohet, konkretisht: kategoria NS-18 A ka të bëjë me punime topogjeodezike, kategoria NP-12 A ka të bëjë me punime te inxhinierise mjedisit, kategoria NP-11 A ka të bëjë me ndërtime per n/stacionet, kabinat e transformatoreve .....etj,

-nuk është vendosur kushti për stafin inxhiniero-teknik, për profesionin e tyre dhe sa duhen, në përputhje me llojin e punimeve,

-kërkohet makineri të ndryshme tek kriteret për kualifikim tek mjete e makineri në dispozicion, por nuk kërkohet “makineria Rul” për ngjeshjen e shtresave, për zërin e punës sipas preventivit të miratuar “shtresë çakulli 960 m2 me t=20 cm e përhapur dhe ngjeshur me makineri”.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 15, 26/5, 28/2/4/ç/5/c e ç, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar neni 45, me kërkesat e VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu II, pika 2.

**8. M.M.** juriste e bashkisë Këlcyrë, për shkeljet e mëposhtme:

-Për shkelje në cilësinë e kryetares të njësisë të prokurimit, në hartimin e disa kriteret të vecanta të kualifikimit, në procedurat e prokurimit, në objektin “Sistemim asfaltim unaza Këlcyrë faza e II” Bashkia Këlcyrë, për vitin 2015, pasi njësia e prokurimit këto kriteret të vecanta kualifikimi i ka formuluar të pasakta, të cilat kanë ndikuar në eliminimin e operatorëve ekonomik, konkretisht:

-kërkohet numëri i fuqisë punëtore për 2 vjet (për periudhën janar 2014 deri në nëntor 2015), në vend të 3 viteve, siç kërkohet xhiro vjetore dhe shlyerja e taksave vendore për 3 vitet.

-kërkohet në kriteret për kualifikim kategori të cilat nuk kanë lidhje me objektin që prokurohet, konkretisht: kategoria NS-18 A ka të bëjë me punime topogjeodezike, kategoria NP-12 A ka të bëjë me punime te inxhinierise mjedisit, kategoria NP-11 A ka të bëjë me ndërtime per n/stacionet, kabinat e transformatoreve .....etj,

-nuk është vendosur kushti për stafin inxhiniero-teknik, për profesionin e tyre dhe sa duhen, në përputhje me llojin e punimeve,

-kërkohet makineri të ndryshme tek kriteret për kualifikim tek mjete e makineri në dispozicion, por nuk kërkohet “makineria Rul” për ngjeshjen e shtresave, për zërin e punës sipas preventivit të miratuar “shtresë çakulli 960 m2 me t=20 cm e përhapur dhe ngjeshur me makineri”.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 15, 26/5, 28/2/4/ç/5/c e ç, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar neni 45, me kërkesat e VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu II, pika 2.

**“Vërejtje”, për 6 punonjës, si më poshtë:**

**9. B.I.** me detyrë Përgjegjës i zyrës së urbanistikës, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos menaxhim të mirë të situatës, në lidhje me asetet e paluajtshme që ka në pronësi dhe në përdorim si rezultat i mos regjistrimit të drejtave të pronësisë apo përdorimit, kryerjes jo në përputhje me përcaktimet ligjore të procesit të inventarizimit dhe marrjes së tyre në dorëzim, mos ushtrimit të kontrolleve dhe saktësisimit të kufijve të pronave, numrave të pasurisë sipas zonave përkatëse kadastrale, mos shfrytëzimit të tyre në formën e qiradhënies, përfshi dhe tokat bujqësore të pandara në dispozicion, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjit nr. 33-2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001.

**10. E.L.** me detyrë sekretar i kryetarit bashkisë, për shkeljet e mëposhtme:

-Gjatë kryerjes së detyrës së përgjegjësit të zyrës taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Këlcyrë për periudhën 11.03.2014-31.08.2015, nuk janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore nga subjektet private dhe familjare në vlerën 10,190 mijë lekë, si dhe nuk është krijuar regjistri i taksave vendore për tatimpaguesit familjar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor”, të ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar dhe pikën 7, neni 4 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

-Gjatë kryerjes së detyrës së inspektorit të policisë bashkiake për periudhën 01.01.2013-30.06.2016, nuk është dokumentuar veprimtaria e përditshme e policisë bashkiake, nuk është mbajtur libri i shërbimit 24 orësh, nuk janë ushtruar kontrole për mbrojtjen e mjedisit, pronës, respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes, të parkimit etj., nuk është ushtruar kontroll dhe vendosur asnjë gjobë për ndëshkimin e personave që kryejnë kundravajtje administrative. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 14, pika 8 dhe lidhjen nr. 1-3 të urdhrit të përbashkët të Ministrit të Rendit dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores së brendshme Tip të policisë bashkiake e të komunës” në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin, funksionimin e policisë bashkisë dhe të komunës”.

**11. B.A.** për arsye se gjatë kryerjes së detyrës së inspektorit të zyrës së taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Këlcyrë prej datës 01.01.2013-30.06.2016,

nuk ka ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore nga subjektet private dhe familjare në vlerën 19,898 mijë lekë, si dhe nuk ka krijuar regjistrin e taksave vendore për tatimpaguesit familjar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor”, të ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, pikën 7, neni 4 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

**12. A.P.** për arsye se gjatë kryerjes së detyrës së inspektorit të policisë bashkiake për periudhën 01.01.2013-30.06.2016, nuk është dokumentuar veprimtaria e përditshme e policisë bashkiake, nuk është mbajtur libri i shërbimit 24 orësh, nuk janë ushtruar kontrole për mbrojtjen e mjedisit, pronës, respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes, të parkimit etj., nuk është ushtruar kontroll dhe vendosur asnjë gjobë për ndëshkimin e personave që kryejnë kundravajtje administrative. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 14, pika 8 dhe lidhjen nr.1-3 të urdhrit të përbashkët të Ministrit të Rendit dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores së brendshme Tip të policisë bashkiake e të komunës” në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”.

**13. V.K.** me detyrë përgjegjëse e zyrës financës të bashkisë Këlcyrë (*prill 2016 e vazhdim*), për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH për vlerën 4,096,510 lekë, sipas shkresave nr. 434/53, datë 01.07.2013 dhe nr. 351/68, datë 2.2.2011,

-Për mos administrimin e shërbimit të pastrimit të qytetit Këlcyrë për vitin 2015-2016, pasi paraqet kosto më të lartë se firma sipërmarrëse e pastrimit e cila e mbulonte këtë shërbim për vitin 2014, çka ka ndikuar negativisht në buxhetin e bashkisë për vlerën 2,2 milion lekë. Për mos marrjen e masave për kalimin e shërbimit të pastrimit të qytetit nga administrimi i bashkisë me sipërmarrje private, pasi nuk ka qenë me efektivitet.

-Për mos shfrytëzimin të pronave që nga viti 2008, të cilat kanë kaluar në përdorim të ish-Bashkisë dhe janë jashtë kontrollit dhe administrimit të së drejtës së përdorimit, pa u vënë në efikasitet, pasi nuk janë dhënë me qira, çka ka krijuar efekte financiare për Buxhetin e Bashkisë në vlerën 10,894,800 lekë të ardhura të munguara, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014.

-Për mos monitorim të kontratës së qirasë lidhur midis Bashkisë Këlcyrë dhe [REDACTED] sh.a, dhe mos azhurnim të saktë të tarifës të vlerës së qirasë lek/ha/vit, çka krijuar efektin financiar në vlerën 2,825,634 lekë dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë, detyrim qiraje i pa arkëtuar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

-Për mos derdhje në buxhetin e shtetit, të tatimit në burim për të ardhurat nga qiratë në vlerën 419,500 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar, neni 33 germa "ë", "pagesat për qiratë".

**14. P.J.** topograf komunës, në cilësinë anëtarit njësisë prokurimit, për shkeljet si më poshtë:

a. Në procedurën e prokurimit publik me objekt "Blerje Nafte" kërkesë për propozim Mallra, të vitit 2013 në ish-Komunën Dëshnice, rezultoi se: në hartimin e kriterëve për kualifikim nuk është zbatuar VKM nr.1, datë 10.01.2007, Kreu III "Dokumentet e tenderit" pika 3, germa (b); nuk ka kërkuar kopje të një apo më shumë bilanceve të vërtetuara nga autoritetet përkatëse, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, Kreu III "Dokumentet e tenderit" pika 3 "Informacione të veçanta" germa (b), nënpika (i) dhe dokumentet e tenderit nuk janë miratuar nga titullari Autoritetit Kontraktor.

b. Në procedurën e prokurimit publik me objekt "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundishte" procedurë e hapur, të vitit 2013 në ish-Komunën Dëshnice, rezultoi se: Për kategoritë NP 1 dhe NP 5 është kërkuar niveli B, të cilat mbas shtojcës së modifikimit të DST niveli i këtyre kategorive ndryshohet në A, në një kohë që duhet të ishte niveli B, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar.

## **E. TË TJERA.**

Auditimi i kryer në Bashkinë Këlcyrë, vlerësohet shumë dobët nga Kryetari i KLSH-së dhe do të riauditohet në një kohë të dytë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Drejtoria Juridike, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**